

**DOKUMENT I BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

STRATEGJI PËR SHQIPËRINË

Miraturar nga Bordi i Drejtorëve, Prill 2004

I.	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
II.	STRATEGJIA PËR VENDIN	4
1.	PORTOFOLI I BANKËS.....	4
1.1	Përmbledhje e aktiviteteve të deritanishme.....	4
1.2	Implementimi i strategjisë së kaluar	5
1.3	Impakti në tranzicion dhe mësimet e përfituara.....	7
1.4	Të dhëna dhe cilësia e portofolit.....	11
2.	MJEDISI I VEPRIMTARISË	12
2.1	Mjedisi i përgjithshëm i reformave	12
2.2	Mjedisi ekonomik	16
3.	PROGRESI DHE SFIDAT E TRANZICIONIT	20
3.1	Zhvillimi i sektorit privat	20
3.2	Sektori financiar.....	21
3.3	Sektori i infrastrukturës.....	22
4.	ORIENTIMET STRATEGJIKE	24
4.1	Prioritetet e bankës për periudhën e strategjisë.....	24
4.2	Zhvillimi i sektorit privat	24
4.3	Sektori financiar.....	25
4.4	Sektori i infrastrukturës.....	26
5.	BASHKËPUNIMI ME DONATORË DHE INSTITUCIONE TË TJERË.....	29
III.	SHTOJCA	31
	SHTOJCA 1: VLERËSIM POLITIK	31
	SHTOJCA 2: TRANZICIONI LIGJOR	32
	SHTOJCA 3: TREGUES TË ZGJEDHUR EKONOMIKË	38
	SHTOJCA 4: PROJEKTE TË APROVUARA TË BANKËS.....	39
	SHTOJCA 5: PROGRAME TË BERZH-IT PËR BASHKËPUNIM TEKNIK	40
	SHTOJCA 6: ASISTENCA MULTI DHE BILATERALE	43

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria vazhdon të përmbushë kushtet e përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Krijimin e Bankës. Zhvillimi i zgjedhjeve të fundit duke përfshirë edhe zgjedhjet lokale të Tetorit 2003, shënoi një përmirësim të dukshëm në krahasim me vitet 1990, por pati përsëri parregullsi të ndjeshme. Zgjedhjet e fundit lokale u përsëritën në shumë zona, duke përfshirë edhe më shumë së një të tretën e zonave të kryeqytetit, Tiranë. Opozita, e përfaqësuar nga Partia Demokratike ka braktisur metodën e saj të mëparshme të bojkotimit të parlamentit, por vazhdon të organizojë demonstrata të vazhdueshme në rrugë kundër qeverisë, të cilat kanë tërhequr gjithnjë e më shumë pjesëmarrës, duke pasqyruar praninë e një ndjenje gjithpërfshirëse anti-korrupsion dhe pakënaqësi në rritje për ngritjen e çmimeve dhe aspekte të tjera të politikave ekonomike të qeverisjes aktuale të cilat prekin kushtet e jetesës. Fatos Nano siguroi ri-zgjedhjen si Kryetar i Partisë Socialiste në Dhjetor 2003 dhe arriti me sukses të bënte një riorganizim të qeverisë në Janar 2004. Megjithatë, tensione të vazhdueshme në brendësi të Partisë Socialiste në fuqi paraqesin një element të shtesë paqartësie në veprimtarinë e përditëshme të administratës publike.

Në skenën ndërkombëtare, Shqipëria vazhdon të luajë një rol konstruktiv në Evropën Jug-Lindore. Shteti ka nënshkruar, dhe në shumicën e rasteve ka implementuar marrëveshje të tregëtisë së lirë me të gjitha vëndet fqinje të rajonit dhe me Kosovën. Shqipëria gjithashtu ka treguar vetëpërmbytje në politikat e saj zyrtare me Serbinë dhe Malin e Zi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për sa i përket çështjes së Shqiptarëve etnikë në ato vende. Në Janar 2003, vendi filloi negociatat formale me BE-në mbi një Marrëveshje Stabilizimi dhe Asociimi, por progresi ka qënë shumë i ngadalhtë.

Megjithëse filloi nga një bazë shumë e ulët, Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm në të gjitha fushat që nga viti 1997. Nga viti 1998 deri në 2001, ekonomia u rrit me ritme vjetore prej 7-8 përqind. Pas një ngadalësimi të përkohshëm në 2002, të shkaktuar nga një krizë energjitike dhe nga përmbytjet e vjeshtës, rritja reale e PBB-së në 2003 është rikthyer në ritmet vjetore prej 6 përqind. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla mund të konsiderohet i përfunduar dhe sektori privat tani punëson rreth 80% të fuqisë punëtore. Inflacioni është i ulët, kursi i këmbimit valutë është i qëndrueshëm dhe rezervat valutë mbahen në nivele të kënaqshme duke mbuluar më shumë se katër muaj importe. Defiçiti buxhetor mbetet i lartë, në një nivel të vlerësuar në 5.6 përqind të PBB-së në fund të vitit 2003 (duke përjashtuar grantet), por është ulur në vitin e fundit si pasojë e një rritjeje të ndjeshme në të ardhura si rezultat i përmirësimeve në punën e administratës tatimore dhe doganore. Gjatë dy viteve të fundit ka pasur përparim në reformat strukturore, përmirësim në dialogun midis qeverisë dhe komunitetit të biznesit, përparime në komercializimin e ndërmarrjeve publike dhe hapa serioze për rivitalizimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha.

Megjithatë, Shqipëria vazhdon të vuajë nga probleme të tilla si: nivel i lartë korrupsioni, mangësi në punën e organeve të rendit dhe kapacitet i ulët administrativ dhe institucional. Megjithë rritjen e shpejtë ekonomike të viteve të fundit, të ardhurat për frymë rreth 1,800 Dollarë amerikanë janë ende ndër më të ultat në Evropë.

Nivelet e varfërisë vazhdojnë të jenë të larta, sidomos në zonat rurale, dhe rreth një e katërta e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë prej 2 Dollarë amerikanë për frymë në ditë. Reduktimi i varfërisë dhe përmirësimi i shëndetësisë dhe arsimit janë prioritet kryesor të Strategjisë për Rritjen Ekonomike dhe Uljen e Varfërisë, të adoptuar në Nëntor 2001 dhe të mbështetur nga FMN, Banka Botërore dhe komuniteti ndërkombëtar i donatorëve. Aftësia ripaguese për borxhin publik mbetet shqetësuese. Niveli i borxhit të jashtëm është relativisht i ulët, rreth 23 përqind i PBB-së, por borxhi i brendshëm është i lartë, duke arritur aktualisht në rreth 38 përqind të PBB-së. Kreditë e zbutura nga organizatat ndërkombëtare mbeten burimi kryesor i huasë së jashtme të qeverisë. Kufiri i borxhit të butë vjetor i caktuar nga FMN, për vitin 2003 u rrit nga 100 milionë Dollarë amerikanë të vitit të kaluar në 130 milionë. Megjithë privatizimin kohët e fundit të bankës më të madhe dhe të fundit në pronësi shtetërore, Bankës së Kursimeve, niveli i përgjithshëm i investimeve të huaja direkte (FDI), 1.128 miliard Dollarë amerikanë (330 USD për frymë) në fund të vitit 2003, ishte nga me të ulët në rajon.

Sfidat kryesore të tranzicionit për Shqipërinë janë: (i) inkurajimi i zhvillimit të sektorit privat, veçanërisht i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), dhe përfshirja e një pjese të mirë të sektorit të konsiderueshëm jo-formal në ekonominë formale. Kjo kërkon më shumë mundësi për financim, por ç'është më e rëndësishme, kërkon përmirësim të mëtejshëm të klimës së investimeve përmes krijimit dhe zbatimit me forcë të një kuadri më të mirë ligjor, përpjekjeve të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe rritjes e forcimit të kapaciteteve administrative dhe institucionale; (ii) komercializimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve publike të shërbimeve në energji dhe ujëra si dhe në sektorin financiar për të rritur konkurrencën, përmirësuar shërbimet dhe futur aftësi të reja menaxhimi; dhe (iii) kryerja e investimeve themelore në infrastrukturën e rrënuar të vendit, duke përfshirë përpjekje të mëtejshme për zgjidhjen e krizës energjitike, përmirësim të shërbimeve bashkiake dhe forcimin e rrjeteve lokale dhe ndërkombëtare të transportit.

Banka është e vendosur të mbështesë përpjekjet e vendit në trajtimin e këtyre sfidave. Gjatë periudhës së mbuluar nga kjo strategji, Banka do t'i përqëndrojë përpjekjet e saj në zhvillimin e sektorit privat, duke i balancuar këto me mbështetje për infrastrukturën e domosdoshme publike. Përpjekjet e Bankës do të plotësohen me dialog mbi politikën në mbështetje të zhvillimit institucional, rritjes së kapacitetit për thithjen e investimeve dhe përmirësimin të kuadrit ligjor dhe administrative. Banka do të përqëndrohet si në implementimin e projekteve ekzistuese, me objektiv rritjen e lëvrimin të kredive, ashtu edhe në nxitjen dhe zhvillimin e projekteve të reja sipas prioritetëve të mëposhtme:

Zhvillimi i sektorit privat. Banka do të ripërtërijë përpjekjet e saj për të luajtur një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe zhvillimin e sektorit privat, përmes përfshirjes së saj në sipërmarrje të privatizuara dhe të sapokrijuara, duke u përqëndruar në industrinë e përgjithshme dhe agrobiznes. Paralelisht, Banka do të ofrojë mbështetje për privatizimet e ardhshme, si në sektorin e shërbimeve (telekom), nëpërmjet sigurimit të financimeve afatgjatë para ose pas privatizimit.

Sektori financiar. Banka do të përpiqet të mbështesë forcimin e sektorit financiar si një faktor kyç për zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm. Ajo do të fokusohet në

zhvillimin e produkteve dhe institucioneve që tashmë veprojnë në vende të tjera si mjete të ndarjes së riskut të mbështetura nga donatorët dhe skemave të huave për SME-të të kombinuara me fonde asistence teknike me objektiv rritjen e kapacitetit të bankave lokale dhe rritjen e ndërmjetësimit financiar. Banka gjithashtu do të punojë për kompletimin e privatizimit të kompanisë së sigurimeve INSIG.

Infrastruktura. Mbështetja e rehabilitimit të infrastrukturës së vendit dhe integrimi i saj në rajon do të mbetet një prioritet për Bankën. Financimet me garanci shtetërore do të vlerësohen duke konsideruar limitet e huamarrjes së vendit dhe një theks i vazhdueshëm do të vihet mbi bashkë-financimet me donatorë të tjerë. Banka do të fokusohet në fushat e mëposhtme:

- **Energjitika** – Banka do të sigurojë financim për kapacitete të reja të prodhimit të energjisë elektrike dhe do të mbështesë rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit nëpërmjet integritit rajonal. Implementimi i projekteve ekzistuese të transmetimit dhe shpërndarjes do të vazhdojë të mbetet një prioritet.
- **Transportet** – Prioriteti i Bankës do të jetë përmirësimi i një segmenti të ri të rrjetit kryesor rrugor (lidhja rajonale me Greqinë) përveç implementimit të projektit ekzistues për rehabilitimin e rrugës Elbasan-Librazhd. Banka do të ofrojë mbështetje për konçesionin privat për Aeroportin e Tiranës dhe do të eksplorojë mundësi bashkë-financimi me institucione të tjera financiare në fusha të tjera si portet.
- **Infrastruktura bashkiake dhe mjedisore** – Do të jetë prioritet zhvillimi i projekteve në sektorin e infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore duke u fokusuar kryesisht në furnizimin me ujë të pijshëm dhe mundësisht në transportin urban dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

Banka do të ndjekë objektivat e propozuara operative dhe dialogun e bashkërenduar mbi politikat në bashkëpunim të afërt me BB-në, BE-në, BEI-n dhe institucione e donatorë të tjere në mënyrë që të sigurojë një implementim të sukseshëm të strategjisë së saj.

II. STRATEGJIA PËR VENDIN

1. PORTOFOLI I BANKËS

1.1 Përmbledhje e aktiviteteve të deritanishme

Në fund të Dhjetorit 2003, Banka arriti një volum të përgjithshëm biznesi prej 172.5 milionë Euro (për një vlerë totale projektesh prej 499 milionë) në sektorë si energjitikë, infrastrukturë, institucione financiare, telekome, hoteleri dhe industri të përgjithshme (shih Shtojcën 4). Portofoli aktual arrin në 132 milionë Euro (13 projekte), nga të cilat 39 milionë Euro janë aktive operative. Portofoli neto është rritur me 48 përqind në dy vitet e fundit. Rritja është e ndjeshme, megjithë anulimin e Projektit të Fabrikës së Çimentos në Elbasan (16.9 milionë Euro) i cili u ridizenjua nga sponsori dhe po ri-analizohet nga Banka për një financim mbi baza të reja. Rritja u gjenerua kryesisht nga projekte në sektorin e infrastrukturës (energjitika dhe transporti, 39% volumit të ri të biznesit) dhe telekomunikacionit (financimi i Vodafone Albania, 54% i volumit të ri të biznesit). Aktivitet operative përbëjnë vetëm 29% të portofolit aktual. Niveli shumë i ulët i lëvrimit rrjedh së pari nga dhënia e huasë (Dhjetor 2003) ndaj Vodafonit e cila ende nuk ka filluar të lëvrohet dhe së dyti nga vonesat në implementimin e dy projekteve në sektorin e energjitikës me Kompaninë Energjitikë Shqiptare (KESH) dhe të një projekti në sektorin e rrugëve, për të cilin u pa e nevojshme të rishikohej projekti teknik dhe të merreshin fonde shtesë. Te tre këto kredi kanë filluar tashmë të lëvrohen normalisht dhe niveli i lëvrimit të kredive pritet të përmirësohet ndjeshëm për dy vitet e ardhshme.

Tab 1.1 Portofoli i Bankës në Shqipëri

Emri i Sektorit	PORTOFOLI KUMULATIV						PORTOFOLI NETO		
	Num. Projekte	Kosto totale të projektit	Nënsh. nga BERZH	% nënshk. nga BERZH	Disbursuar	% i të nënshk.	Num. i projekteve	Portfoli	%
Institucione Financiare	8	43.5	18.2	10.6%	9.7	53%	6	13	10%
<i>Banka</i>	4	28	10.7	6.2%	7.1	66%	4	6.4	5%
<i>Fonde Kapitali</i>	1	6.1	2.8	1.6%	2.6	93%	1	1.9	1%
<i>Jo Bankare</i>	1	9.4	4.7	2.8%	0	0%	1	4.7	4%
Infrastruktura	3	278.5	71	41.2%	25.5	36%	3	65	49%
<i>Energjitikë</i>	2	253.6	54	31.3%	22	41%	2	48	36%
<i>Transport</i>	1	24.9	17	9.9%	3.5	21%	1	17	13%
Industri të Specializuara	5	177.2	83.3	48.3%	40.8	49%	4	53.9	41%
<i>Telekomunikacione</i>	2	124.1	50.3	29.2%	7.8	16%	2	45	34%
<i>Agrobiznes</i>	1	10.9	3.2	1.9%	3.2	100%	0	0	0%
<i>Prona, Turizem & Transport Mallrash</i>	2	42.2	29.8	17.2%	29.8	100%	2	8.9	7%
Totali	16	499.2	172.5	100.0%	76	44%	13	131.9	100%

Portofoli i bankës në Shqipëri është përqëndruar në infrastrukturë dhe telekomunikacione me 83 përqind të portofolit total aktual. Në terma relative, angazhimet më të mëdha janë në fushën e energjitikës (36 përqind të portofolit total), telekomunikacioneve (34 përqind) dhe transportit (13 përqind). Kjo situatë është rezultat i përmasave shumë më të mëdha të projekteve të infrastrukturës dhe telekomunikacioneve në krahasim me projektet në sektorët e tjerë. Në përgjithësi,

portofoli është i shpërndarë në mënyrë të balancuar përsa i përket numrit të projekteve në sektorë të ndryshëm. Borxhi prej 124 milionë Euro përbën 94 përqind të portofolit dhe investimet në aksione prej 8 milionë Euro përbëjnë pjesën e mbetur prej 6 përqind.

Rreth 327 milionë Euro u angazhuan në formë bashkë-investimesh nga sponsor, bashkëfinancues dhe donatorë të tjerë në projekte të BERZH-it. Fondet nga donatorët dhe financimet e buta u angazhuan për një numër projektesh si: projekti *Për Rehabilitimin e Rrugëve* (Itali, CEI), projekti *Për Rehabilitimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike* (Itali, BEI, BB, Spanjë, Zvicër, Austri, Japoni, JBIC), *Albtelekom* (Norvegji, Zvicër, Itali) dhe Fondi Shqiptar i Investimeve për Rindërtim (Itali).

Duke punuar me donatorë të ndryshëm, Banka ka mobilizuar fonde për 77 projekte bashkëpunimi teknik kryesisht në sektorin bankar, telekomunikacione, energjitikë, transporte, sigurime, dhe industrinë prodhuese. Fondet totale të angazhuar për bashkëpunim teknik arrijnë në 16 milionë Euro, duke paraqitur një raport 1:10 në krahasim me portofolin e projekteve. Fondet e lëvruar për bashkëpunim teknik arritën 12 milionë Euro në fund të vitit 2003 (shih Shtojcën 6).

1.2 Implementimi i strategjisë së kaluar

Strategjia e kaluar, e aprovuar në Prill 2002, përcaktoi prioritetet strategjike të mëposhtme për Bankën në Shqipëri: (i) nxitja e zhvillimit të sektorit privat, vecanërisht e biznesit të vogël dhe të mesëm, me anë të investimeve direkte në kompani të privatizuara ose të krijuara rishtazi, mbështetjes e forcimit të sektorit bankar dhe përmirësimit të strukturave të kreditit dhe tregtisë dhe nëpërmjet implementimit të vazhdueshëm të mjeteve ekzistuese të kreditimit (fonde për investim); (ii) ndihmë dhe mbështetje direkte për përfundimin e privatizimeve strategjike të mëdha; (iii) mbështetje e mëtejshme për zhvillimin e projekteve kyçe të infrastrukturës në energjitikë, transporte dhe telekomunikacione.

Gjatë dy viteve të fundit (Janar 2002 – Dhjetor 2003), BERZH-i ka angazhuar 89.3 milionë Euro në katër projekte të reja dhe disa investimeve në biznese të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit ekzistues të investimeve. Në përgjithësi, Banka ka qenë e sukseshme në arritjen e objektivave të saj në sektorët e telekomit dhe infrastrukturës dhe në mbështetjen e privatizimit, por ka hasur më tepër vështirësi në aktivitetet e zhvillimit të sektorit privat.

Në vitin 2003, BERZH-i nënshkroi dy investime të reja (47.2 milionë Euro). Banka angazhoi 42.5 milionë Euro (nga të cilat 7.5 milionë Euro të financuara nëpërmjet bankave lokale) për financimin e rrjetit të telefonisë celulare të *Vodafone Albania*, operatori i dytë celular në vend, dhe nënshkroi blerjen e 19 përqind (4.7 milionë Euro) të aksioneve të *INSIG-ut*, kompania shtetërore e sigurimeve, në fazën e parë të privatizimit të saj. Të dy projektet janë transaksione të nivelit të lartë të orientuara drejt sektorit privat, të cilat sinjalizojnë progresin e Shqipërisë në ristrukturimin dhe privatizimin e kompanive (para-privatizimi i *INSIG-ut*) dhe hapja ndaj investimeve të huaja direkte (investimi nga *Vodafone Albania*).

Për më tepër, në sektorin e biznesit të vogël dhe të mesëm, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Investimeve për Rindërtim, Banka nënshkroi 5 projekte me kompani lokale për një total prej 2.2 milionë Euro (1.1 milionë Euro u bashkëfinancuan nga Qeveria Italiane). Megjithatë ritmi i investimeve të Fondit ishte më i ngadaltë se parashikimet dhe periudha investuese e Fondit mbaroi në Nëntor 2003. Në të ardhmen Fondi do të monitorojë portofolin ekzistues dhe do të përqëndrohet në praktikat menaxhuese të kompanive dhe daljen nga investimet.

Gjatë viteve 2002-3 nuk u lëvruan fonde të tjera në kuadrin e *Linjës së Kredisë për Zhvillimin e Biznesit të Vogël dhe të Mesëm*, apo *Programit për Lehtësimin e Tregtisë* me bankat lokale, si pasojë e një kombinimi faktorësh si: probleme me pronësinë dhe administrimin e bankave kliente, mjedisi i vështirë me numër të kufizuar projektesh të përshtatshme financiarisht, ngurrimi i bankave lokale për të rrezikuar në dhënien e kredive për sipërmarrjet e vogla (pjesërisht i trashëguar nga kriza e skemave piramidale të 1997 dhe pjesërisht si rezultat i rregullave strikte të Bankës Qëndrore), prania e burimeve të tjera financuese me mbështetje donatore më pak të shtrenjta, likuiditeti i lartë i bankave dhe mbizotërimi i transaksioneve ekonomike të bazuara në para në dorë (*cash*), të cilët lenë më pak hapësirë për përdorimin e produkteve bankare duke i bërë kështu strukturat e BERZH-it më pak konkurruese. Gjithashtu, mungesa e regjistrave të tokës dhe kadastrave efektive pakëson mundësitë e firmave për të përdorur pronat si kolateral, në një kohë kur bankat kërkojnë nivele të larta kolateralesh, duke ulur si rezultat mundësinë e firmave për të marrë hua nëpërmjet kanaleve zyrtare.

Më tej, madhësia relativisht e vogël dhe natyra e orientuar më shumë nga tregëtia e shumë bizneseve lokale, mungesa e aftësive dhe kapacitetit menaxherial si dhe standarte dhe qeverisje shpesh të papërshtatshme të biznesit, kanë penguar financimin direkt nga ana e Bankës në sektorin lokal (jo-SME) privat të korporatave.

Në vitin 2002, BERZH-i nënshkroi dy projekte (41 milionë Euro). Të dy projektet ishin në sektorin e infrastrukturës publike: financim për rehabilitimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë dhe një financim i ri i ristrukturuar për rehabilitimin e segmentit rrugor Elbasan-Librazhd. Këto projekte u shoqëruan me përpjekje intensive në zgjidhjen e problemeve të mëparshme për implementimin e investimeve në sektorët përkatës. Në sektorin e energjitikës, për nënshkrimin e projektit për *Rehabilitimin e Shpërndarjes së Energjisë* (24 milionë Euro) u vendos si kusht zgjidhja e situatës së projektit të mëparshëm të *Rindërtimit të Sektorit të Energjitikës*, i cili kishte mbetur në vend për shkak të problemeve midis klientit dhe kontraktuesëve. Në sektorin rrugor, projekti i ri *Rehabilitimi i Rrugëve II* (17 milionë Euro) bëri të mundur ndreqjen (dhe zëvendësimin) e një projekt të mëparshëm, i cili ishte me mangësi si pasojë e gabimeve në projektin teknik dhe llogaritjen e kostos. Implementimi i të gjithë këtyre projekteve ka filluar tashmë dhe është vazhdim.

Për sa i përket menaxhimit të portofolit, BERZH-i, në bashkëpunim me IFC-në dhe Bankën e Shqipërisë, ka bërë përpjekje të rëndësishme për të zgjidhur situatën e Bankës Kombëtare Tregtare, e privatizuar me pjesëmarrjen e BERZH-it në vitin 2000, ku Sponsori dështoi për shkak të krizës bankare në Turqi. Çështja tani po i afrohet zgjidhjes pas hyrjes së një investitori të ri strategjik turk. Banka gjithashtu është fokusuar në mënyrë intensive për rikthimin e investimit problematik të Hotel Tiranës. Këto përpjekje po tregohen të frytshme: është rënë dakord me Qeverinë mbi një

propozim për privatizimin e kompanisë nëpërmjet një shitje në ankand të aktiveve të saj. Kjo do të sjellë një efekt demonstrativ të dobishëm përsa i përket zbatimit të disiplinës financiare dhe të drejtave të kreditorëve. Së fundmi, në marrëveshje me Sponsorin, banka anuloi huanë e palëvruar për Seament Albania për rehabilitimin e *Fabrikës së Çimentos në Elbasan*. Sponsorin ka marrë në pronësi një fabrikë tjetër në Shqipëri dhe ka ndryshuar strategjinë e përgjithshme të investimit në vend. Banka është tashmë duke konsideruar mundësinë për të dhënë financim për një projekt të ri të ri-dizenjuar nga Sponsorin.

1.3 Impakti në tranzicion dhe mësimet e përfituara

Banka ka luajtur një rol thelbësor në nxitjen dhe mbështetjen e tranzicionit në Shqipëri, me anë të investimeve në sektorin privat dhe atë publik. Roli i Bankës ka evoluar me kalimin e kohës në varësi të sfidave më të cilat është përballuar vendi. Investimet e Bankës kanë pasur efekt demonstrativ dhe impakt të vlefshëm në tranzicion, sidomos në sektorët e financave, të telekomunikacionit e të energjitikës dhe në një masë më të vogël në sektorin industrial dhe atë të transporteve.

Sektori privat i korporatave

Banka ka mbështetur tranzicionin në Shqipëri nëpërmjet investimeve direkte në sipërmarrjet private. Investimet në sektorin privat (Coca Cola Albania, Vodafone Albania) kanë efekt të ndjeshëm demonstrativ dhe inkurajojnë investimet e huaja private në vend. Megjithatë, nevojitet një përpjekje dhe përfshirje më e madhe për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë edhe investime me sponsora lokalë.

Sektori financiar

Sektori bankar – Banka ka dhënë një kontribut të rëndësishëm fillestar në zhvillimin e sistemit bankar nëpërmjet investimeve në kapital (equity) dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë në privatizimin e bankave. Pjesëmarrja e Bankës ka qenë një element thelbësor në themelimin e Bankës Italo-Shqiptare (BIA) në 1994, banka e parë private në Shqipëri, e themeluar si një *joint-venture* midis Bankës Kombëtare Tregtare dhe *Banca di Roma*. Në vitin 1999, Banka u bë një nga aksionerët themelues të FEFAD Bank, një institucion mikro-financues, i riemëruar si “ProCredit Bank Albania” në 2003. Në vitin 2000, kontributi i BERZH-it në sektorin bankar u zgjerua më tepër me anë të pjesëmarrjes (bashkë me IFC-në) në privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) nga Kentbank e Turqisë, shitja e parë e një banke me mbulim kombëtar në vend.

Megjithatë, në dy nga investimet e mësipërme, impakti i Bankës në tranzicion u zvogëluar më vonë. Probleme serioze me menaxhimin e brendshëm të BIA-s penguan zhvillimin e aktiviteteve të kësaj banke. Pjesëmarrja e BERZH-it (edhe me anë të përfaqësimit të saj në bordin drejtues) ka qenë thelbësore në zgjidhjen e situatës. Në rastin e BKT-së, falimentimi i Kentbank gjatë krizës financiare në Turqi të vitit 2001 e la bankën pa një pronar strategjik dhe për më tepër se dy vjet BERZH-i ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me Agjensinë Turke të Rregullimit dhe Mbikqyrjes

Bankare me objektiv sigurimin e një pronari të ri (tashmë në finalizim) dhe ka kontribuar në stabilitetin dhe mirë-funksionimin e BKT-së gjatë kësaj kohe.

Financimi i biznesit të vogël dhe të mesëm (SME) – Banka ka ngritur një linjë kreditimi për SME-të me një bankë lokale dhe programe të lehtësimit të tregtisë (TFP) me dy banka të tjera. Të dy strukturat patën një efekt demonstrativ të kënaqshëm në rikthimin e besueshmërisë në sistemin bankar pas krizës socio-ekonomike të 1997. Ato gjithashtu patën potencialin për një impakt të shkëlqyer në tranzicion. Megjithatë, përdorimi i tyre ishte shumë më ulët sesa pritej për shkak të disa faktorëve të cilët janë rradhitur më sipër (1.2 Implementimi i Strategjisë së Kaluar). Si pasojë, impakti direkt në ekonominë reale i TFP-ve dhe linjave për kreditimin e SME-ve ishte i kufizuar, por këto produkte kontribuan duke ndihmuar bankat pjesëmarrëse në rritjen e kapaciteteve të tyre huadhënëse në kontekstin e përmirësimit të standarteve të tyre operacionale, procedurave të kreditit, trainimit të stafit, etj. Banka po eksploron aktualisht fizibilitetin e metodave më të përshtatshme, për të kapërcyer pengesat ekonomike lokale dhe nxitur financimin e SME-ve.

Krahasimisht, ProCredit Bank Albania ka qenë shumë e suksesshme në zgjerimin e aktivitetit dhe përgjigjjen ndaj nevojave të bizneseve më të vogla dhe sipërmarrësve që më parë kanë pasur shumë pak mundësi kreditimi. Në fund të Janarit 2004, duke mbajtur ndërkohë një portofol mjaft cilësor, ProCredit ka dhënë mbi 14,000 hua për një shumë totale prej 112 milionë Dollarë amerikanë (shuma mesatare e huasë 7,900 Dollarë amerikanë). Si pasojë ProCredit jo vetëm që ka pasur një impakt të fuqishëm në ekonominë reale, por edhe u ka treguar bankave të tjera tregtare që ky segment i tregut është i arritshëm.

Në përpjekjet e saj për të mbështetur zhvillimin e SME-ve, Banka gjithashtu ka ngritur një fond investimesh në Shqipëri në vitin 1998. Fondi ka investuar rreth 37 përqind të burimeve në dispozicion në fund të periudhës së tij investuese (Nëntor 2003), shumë më pak nga sa ishte parashikuar, duke ulur kështu impaktin në tranzicion të projektit. Aktivitetet e tij u penguan nga një klimë e papërshtatshme investimesh dhe vështirësi në kryerjen e investimeve në kapital (equity) në vend. Në mënyrë që të kalojë këto vështirësi, Fondi ka përdorur instrumente të reja financiare (financim në formë borxhi me pjesëmarrje në fitimet e kompanisë). Megjithë pengesat, Fondi arriti të japë financime afatmesme dhe afatgjata për bizneset lokale në një periudhë kur financimi nga bankat lokale mbetej i kufizuar. Për më tepër, Fondi i prezantoi bizneset lokale me instrumente të reja financiare dhe ndikoi në mënyrë pozitive në qeverisjen dhe standartet e biznesit në kompanitë lokale.

Institucionet financiare jo-bankare – BERZH-i ka zgjeruar më tej ndikimin e saj në tranzicionin e sektorit financiar në Shqipëri me anë të pjesëmarrjes kohët e fundit në para-privatizimin e INSIG-ut, kompanisë shtetërore të sigurimeve, me objektiv përmirësimin e menaxhimit të saj dhe përgatitjen për një privatizim të plotë më të mirë e më të volitshëm.

Infrastruktura

Telekomunikacionet – Me anë të investimit të saj në Albtelekom, Banka ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit fiks dhe nga ana institucionale në përmirësimin e sistemeve financiare të kompanisë. Programi i

bashkëpunimit teknik për kuadrin ligjor të sektorit të telekomunikacioneve çoi në miratimin e një Ligji të ri mbi Telekomunikacionet dhe ngritjen e sukseshme të një enti të pavarur rregullator. Megjithatë, privatizimi i kompanisë, provuar të kryhet dy herë më parë, ka dështuar si pasojë e kushteve të papërshtatshme të tregut botëror dhe përcëptimit të aktivitetit të një operatori për linjat fikse në Shqipëri si jo-fitimprurës.

Energjitika – Banka, me anë të investimeve të konsiderueshme për rehabilitimin dhe ristrukturimin e sektorit të energjitikës, po luan një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizës energjitike të vendit, e cila është një pengesë serioze për zhvillimin e sektorit privat dhe hyrjen e investimeve të huaja direkte. Banka ka angazhuar 54 milionë Euro në dy projekte në këtë sektor për rehabilitimin e strukturave për prodhimin e energjisë dhe rehabilitimin e rrjeteve përçues dhe shpërndarës të energjisë, me qëllim rritjen e efikasitetit të prodhimit të energjisë dhe të reduktimit të humbjeve teknike e jo-teknike. Në të njëjtën kohë, Banka po mbështet reformat në sektor duke ndihmuar ristrukturimin dhe ndarjen e KESH-it, me objektiv përgatitjen e kompanisë për privatizim në një periudhë afatmesme. Banka gjithashtu inicioi ko-menaxhimin e KESH-it me një ekip ekspertësh nga një kompani e njohur ndërkombëtare (ENEL i Italisë), duke përmirësuar menaxhimin e kompanisë (në fakt, KESH-i ka pasur mjaft përmirësime gjatë tre viteve të fundit përsa i përket mbledhjes së detyrimeve) dhe duke rritur kapacitetet e saj implementuese.

Transportet – Në vitin 2000, BERZH-i angazhoi 10 milionë Euro për rehabilitimin e aksit rrugor Elbasan – Librazhd, pjesë e korridorit Lindje-Perëndim midis Portit të Durrësit dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Zbatimi i projektit do të përfundonte rehabilitimin e korridorit Lindje-Perëndim dhe do të përmirësonte ndjeshëm komunikimin me vendet fqinje. Projekti pati vonesa të konsiderueshme si pasojë e të metave në të dhënat teknike dhe parashikimin e kostos. Këto të meta ishin rrjedhojë e një projekti jo të mirë teknik dhe koha e gjatë që kaloi nga përfundimi i projektit teknik deri në nënshkrimin e projektit, gjë që rezultoi në kosto më të larta për projektin. Banka kërkoi përgatitjen e një projekti të ri teknik dhe rivlerësimin e kostos së projektit. Më pas, në vitin 2002, u nënshkrua një hua e re prej 17 milionë Euro për të zëvendësuar huanë të mëparshme dhe për të mbuluar kostot shtesë. Zbatimi i projektit filloi në vitin 2003. Përveç ndikimit direkt në rrjetin rrugor, një ndikim i rëndësishëm në tranzicion u arrit me përmirësimin e aftësive teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe të Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacioneve, përmes përgatitjes së një projekti teknik e dokumentash për tender të përshtatshëm, si dhe procedurave transparente të prokurimit.

Banka ka përfituar një sërë mësimesh të vlefshme nga projektet e saj të mëparshme, të cilët mbeten veçanërisht domethënës në kontekstin e strategjisë së ardhshme të Bankës në Shqipëri:

Zbatimi i projekteve në sektorin publik – Eksperienca e deritanishme tregon se dobësitë institucionale, menaxhimi i joefiçent dhe kufizimet buxhetore mund të pengojnë seriozisht zbatimin e projekteve, madje në disa raste mund të bëjnë pamundur përfundimin e projektit. Mësime specifike të mësuara nga Banka nga përfshirja në projekte publike janë:

Në sektorin e energjitikës, mësimi kryesor i përfituar nga projekti i parë i Bankës (*Projekti i Rindërtimit të Sektorit të Energjitikës*) me KESH-in është se zbatimi i

projektit mund të pësojë vonesa serioze si pasojë e mungesës së eksperiencës së huamarrësit me *Politikat dhe Rregullat e Prokurimit të Bankës* dhe si pasojë e kohës që i nevojitet huamarrësit për të aprovuar specifikat e tenderimit. Mësimet u nxorrën gjithashtu nga problemet e dala gjatë implementimit të kontratave të ndryshme të ndërlidhura por të pa financuara nga Banka. Këto përfshijnë: (i) rëndësinë e përbërësve të pavarur për të minimizuar riskun e moszbatimit që rrjedh nga probleme me kontratat e tjera; (ii) rëndësinë e kontratave me përgjegjësi të vetme për të minimizuar koordinimin e nevojshëm midis furnitorëve të huaj dhe kontraktorëve lokale; (iii) marrëveshje të mëparshme për të siguruar kontributet financiare lokale në projekt; dhe (iv) kërkesa të qarta monitorimi dhe raportimi.

Siç u shpjegua më sipër, projekti i parë për transportet i Bankës në Shqipëri (*Rehabilitimi Urgjent i Rrugëve*) pësoi vonesa serioze për shkak të gabimeve në projektim, por gjithashtu edhe për shkak të vonesave në lidhje me shpronësimet e tokave. Mësimet e përfituara përfshijnë: (i) nevojën për të përgatitur projekte teknike të detajuara e me standart të lartë përpara nisjes së një projekti; (ii) pasjen e master planeve mbi përdorimin e tokës dhe transportit përpara së të fillojë përgatitja e projektit teknik; (iii) nevojën e përfundimit të procedurave të shpronësimit të tokës përpara së të nisë zbatimin e kontratave të punimeve civile; dhe (iv) përfshirjen e kushteve të arsyeshme në kontratë dhe monitorimin e rreptë të huave të Bankës.

Financimi i SME-ve nëpërmjet sektorit bankar – Sektori bankar shqiptar, siç u përmend më sipër, është shumë likuid dhe përfiton nga burime financiare jo të kushtueshme. Për më tepër, ekonomia lokale është e bazuar në transaksione me para në dorë (*cash*). Përveç problemeve të pronësisë dhe menaxhimit të përmendura më sipër, këto karakteristika ekonomike krijuan pengesa të mëdha për zbatimin e suksesshëm të projekteve financiare, si linja krediti për biznesin e vogël dhe të mesëm, të cilët kanë qenë të suksesshëm në vende të tjera. Gjatë periudhës që mbulon kjo strategji, Banka do të ndërmarrë përpjekje të reja për të krijuar produkte më të përshtatshëm për nevojat lokale, të cilët ofrojnë shtysë më të fortë për bankat për të bashkëpunuar me bizneset e vegjël dhe të mesëm (nëpërmjet skemave të ndarjes së riskut, asistencës teknike, apo skemave të qarta shpërblyese).

Puna me kompanitë lokale me anë të fondeve të investimit në kapital (equity)– Përdorimi i instrumenteve fleksibël si *quasi-equity* ose struktura të ndarjes së fitimit, të zbatuara me këto fonde investimi mund të ofrojnë një rrugë eficiente për mbështetjen e sektorit privat lokal në një mjedis të vështirë dhe të pasofistikuar veprimi. Megjithatë, skemat të tilla financiare janë me risk të lartë dhe mund të shoqërohen me abuzime nga kompanitë lokale. Ato duhet të shoqërohen me një monitorim intensiv si në nivelin e Bankës (Banka ndaj menaxhimit të fondit) ashtu edhe në nivelin lokal (banka dhe menaxheri i fondit ndaj kompanive lokale ku është investuar).

Qeverisja e biznesit dhe struktura manaxheriale – Eksperienca tregon se pjesëmarrja e investitorëve të huaj ose bashkë-financuesëve të tjerë ndërkombëtarë, nuk është kusht i mjaftueshëm që siguron drejtimin në mënyrën e duhur të kompanisë. Në mënyrë që të sigurohet një qeverisje e mirë e kompanive është e nevojshme që përfaqësuesi i Bankës të luajë një rol aktiv në trupat drejtues të kompanive ku është investuar. Për më tepër, është thelbësore kryerja e një analize të detajuar të historisë së qeverisjes të një kompanie apo investitori. Drejtimi i shoqërisë ka qenë një problem akut në *joint-venture*-at me shtetin, apo ente shtetërore, sidomos në rastet kur aksionerët shtetërore kanë kuota

kontrolluese në shoqëri. Problemet shfaqen kur biznesi drejtohet si një kompani shtetërore, me personel të trashëguar nga e kaluara dhe me aksionerët shtetërore që kanë prioritete dhe dedikime të ndryshëm nga ata privatë, ndërsa banka nuk ka ndikim të mjaftueshëm në Shtet për të bërë ndryshimet e duhura. Banka duhet të shmangë projektet kur Shteti apo kompani shtetërore kanë shumicën kontrolluese, ose nëse një gjë e tillë nuk mund të shmanget, Banka duhet të sigurojë qeverisjen private të kompanisë.

Projekte të bashkëpunimit teknik – Banka ka angazhuar burime të konsiderueshme në projekte bashkëpunimi teknik për të ndihmuar në riparimin e të metave institucionale, disa herë në mënyrë të pavarur nga projekte investimi. Projektet e bashkëpunimit teknik kanë rezultuar gjithmonë të suksesshëm. Eksperienca, sidomos në sektorin e telekomunikacioneve dhe infrastrukturës, provon se që Banka të rrisë ndikimin e projekteve të saj në tranzicion, programet e bashkëpunimit teknik me objektiv ndërtimin e institucioneve, duhet të ndërliidhen me projekte specifike investimi dhe me kushtëzime të tjera të përfshira në projekt.

1.4 Të dhëna dhe cilësia e portofolit

Sipas portofolit aktual prej 132 milionë Euro, 49% e portofolit përbëhet nga investime në sektorin privat, ndërsa 51% në sektorin publik. Shuma e investimeve në shqyrtim është 127 milionë Euro, 46 përqind e së cilës është në sektorin privat. Banka ka si objektiv të qartë rritjen e portofolit në sektorin privat në Shqipëri, por në vëmendjen e saj do të vazhdojnë të mbeten edhe projektet e infrastrukturës dhe projekte të tjerë në sektorin publik, ashtu siç shihet edhe nga investimet në shqyrtim. Gjendja shumë e rënduar e shumicës së infrastrukturës publike mbetet një pengesë serioze për investimet e sektorit privat, qoftë vendor apo i huaj, dhe po shkakton kosto të tepërta për bizneset. Për këtë arsye, zhvillimi i mëtejshëm i sektorit privat do të shkojë paralel me investime shtesë në infrastrukturë (pa harruar nevojën për kushte të tjera lehtësuese për zhvillimin e këtij sektori). Si rrjedhim i përmasave relativisht më të mëdha të projekteve të infrastrukturës në krahasim me shumicën e operacioneve në sektorin privat, pjesa e sektorit privat në portofol nuk ka gjasa të arrijë objektivin prej 60% gjatë periudhës që mbulon kjo strategji.

Duke parë mjedisin e vështirë të veprimtarisë në Shqipëri, risku mesatar i portofolit (6.07) është pak më i lartë se mesatarja dhe veçanërisht një projekt në fushën e hotelarisë po has shumë vështirësi. Aktivitetet në rrezik arrijnë 5 milionë Euro dhe përbëjnë 13 përqind të aktiveve operative. Siç u përmend me sipër, si rezultat i masave të ndërmarra për të rregulluar situatën, projekti në fjalë është tani shumë afër privatizimit (me anë të shitjes së pasurive të paluajtshme), dhe kjo do të lejojë Bankën të rimarrë një pjesë të investimit të saj.

2. MJEDISI I VEPRIMTARISË

2.1 Mjedisi i përgjithshëm i reformave

2.1.1 Zhvillimet politike

Partia Socialiste ka qenë në pushtet që nga mesi i vitit 1997. Ajo arriti të mbajë pushtetin në zgjedhjet parlamentare të verës 2001 dhe arriti të fitojë një shumicë të ngushtë mbi rivalen e saj kryesore, Partinë Demokratike, në zgjedhjet lokale të tetorit 2003. Partia Demokratike e udhëhequr nga ish presidenti Sali Berisha, e ka braktisur politikën e saj të bojkotimit të parlamentit deri në plotësimin e kërkesave të saj, por vazhdon të organizojë demonstrata masive publike të cilat disa herë kanë përshkallëzuar në dhunë. Ato kanë si objektiv shfrytëzimin e pakënaqesisë aktuale popullore mbi skandalet e korrupsionit dhe rritjen e çmimeve. Lufta e brendëshme politike në Partinë Socialiste ka çuar në disa ndryshime të njëpasnjëshme në qeveri gjatë tre viteve të fundit. Ndyshimi më i rëndësishëm ndodhi në korrik 2002, duke sjellë përsëri Fatos Nanon në postin e kryeministrit për herë të tretë. Qeveria e Nanos u vu në shënjestër të sulmeve nga brenda partisë në korrik 2003, kur Ministri i Jashtëm (ish-Kryeministri) Ilir Meta la postin e tij në qeveri. Nano arriti të rifitojë mbështetjen e shumices në PS, u rikonfirmua si kryetar i partisë në kongresin e mbajtur në mes të dhjetorit 2003, dhe arriti të riformojë qeverinë me sukses në janar 2004, por turbullirat brenda PS vazhdojnë ende.

2.1.2 Integrimi rajonal

Qeveria e kryeministrit Nano i ka qëndruar besnike politikës tashmë të përcaktuar mirë të Shqipërisë për të përmirësuar reputacionin ndërkombëtar të vendit. Shqipëria ka nënshkruar dhe në shumicën e rasteve ka implementuar, marrëveshje për tregtinë e lirë më të gjitha vendet fqinje në Evropën jug-lindore dhe me Kosovën. Shqipëria gjithashtu ka treguar vetëpërmbytje në politikat e saj zyrtare me Serbinë dhe Malin e Zi dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për sa i përket çështjes së Shqiptarëve etnikë në ato vende, megjithëse njëfarë tensioni u vu re në lidhjet me Serbinë e Malin e Zi pas nënshkrimit të marrëveshjes për tregëtinë e lirë midis Shqipërisë dhe (në emër të Kosovës) UNMIK-ut në korrik 2003. Shqipëria po bashkëpunon pa rezerva me komunitetin ndërkombëtar për të qetësuar gjëndjen e trazuar aktuale politike në Kosovë. Shqipëria i ka forcuar lidhjet me SHBA-në duke mbështetur luftën në Irak dhe duke rënë dakord për mos-ekstradimin e qytetarëve amerikanë në Gjyqin Ndërkombëtar Kriminal. Në qershor 2003 Shqipëria nënshkroi Kartën e Partneritetit SHBA-Adriatik si një hap drejt futjes në aleancën e NATO-s. Mbledhja e Selanikut për Ballkanin Perëndimor në maj 2003, nuk caktoi një datë të saktë për pranimin e Shqipërisë në BE, por në janar 2003 vendi filloi negociatat zyrtare me BE-në për Paktin e Stabilizimit dhe Asocimit. Negociatat kanë ecur disi përpara, por ecuria e mëtejshme është kufizuar nga vështirësitë e vendit për të zbatuar standartet e BE-së. Arritja e objektivit ambicioz për nënshkrimin e Paktit në 2004 kërkon një vëmendje të plotë ndaj procesit të reformave.

2.1.3 Çështjet e integritetit

Shqipëria ka bërë progres përsa i përket respektimit të përgjithshëm të shtetit të së drejtës. Megjithatë, kjo është një fushë ku sipas raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të botuar në Mars 2003, vendi ka mungesa, sidomos për shkak të institucioneve të dobëta të vendosjes së ligjit, kapacitetit të ulët të administratës publike dhe përhapjes së gjerë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Korrupsioni dhe sjellja e papërshtatëshme profesionale e organeve gjyqësore vazhdon të paraqesë një problem serioz. Sipas autoriteteve shqiptare, gjatë 2002, 12 prokurorë u liruan nga puna dhe u morën masa të ndryshme ndëshkimore ndaj 23 të tjerëve. Pesë gjyqtarë u liruan dhe dy u paralajmëruan. Megjithatë nuk pati asnjë ndjekje penale ndaj tyre. Nga 213 rastet gjyqësore të hapura kundër trafikantëve në nëntë muajt e parë të 2002, vetëm 37 dolën në gjyq dhe 176 u anuluan për shkak të provave të pamjaftueshme dhe gabimeve proceduriale në gjykata. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i *Transparency International* për 2003 e renditi Shqipërinë në vendin e 92-të nga 133 vende (midis vendeve në tranzicion, Shqipëria është renditur përpara 10 vendeve të tjera).

Megjithë bashkëpunimin më të mirë midis autoriteteve të sigurisë italiane dhe atyre shqiptare, hyrja ilegale e organizuar e njerëzve nga Adriatiku vazhdon. Shqipëria është një vend burim dhe tranzit për trafikimin sipas raportit të Departamentit të Shtetit Amerikan të marsit 2003 mbi të drejtat e njeriut në Shqipëri. Në janar 2004, 21 shqiptarë u mbytën kur ata ishin duke u përpjekur të arrinin brigjet italiane dhe barka e tyre u përmbys. Disa zyrtarë, duke përfshirë edhe shefin lokal të policisë së portit të Vlorës u arrestuan dhe shumë të tjerë u pushuan nga puna. Megjithëse numri i shqiptarëve të destinuar për trafikim në vende të tjera ka rënë, vendi mbetet një pikë e rëndësishme ky origjinon trafiku njerëzor. Shumica e vajzave të reja të trafikuarra u kaluan në Itali, Greqi dhe me pak në vende të tjera Evropiane. Shumica e këtyre viktimave u çuan në Vlorë për t'u transportuar me skafe, megjithëse edhe porti i Durrësit përdoret edhe për këtë qëllim. Femrat e huaja në tranzit janë kryesisht qytetare nga Modavia, Rumania dhe në numër më të vogël nga Ukraina, Rusia, Kosova dhe Bullgaria.

2.1.4 Kushtet sociale

PBB për frymë i Shqipërisë, rreth 1,800 Dollarë amerikanë, është një nga më të ultët në Evropë. Megjithë rritjen relativisht të shpejtë të viteve të fundit, nivelet e varfërisë mbeten të larta me 25 përqind të popullsisë që jeton me më pak së 2 dollarë në ditë, sipas një studimi të kryer në 2002 nga INSTAT-i. Rreth 57 përqind e popullsisë jeton në zona rurale dhe rreth një e treta e PBB-së gjenerohet nga bujqësia. Popullsia e vendit u pakësua pas rënies së komunizmit dhe sipas numërimit të vitit 2001 ishte rreth 3,069,000, rreth 60 përqind e së cilës nën moshën 34 vjeç. Rreth 600,000 shqiptare vlerësohet se punojnë jashtë shtetit, sidomos në Greqi dhe Itali.

Minoritetet kombëtare në Shqipëri, më i rëndësishmi nga të cilët është ai grek, përbënin rreth 2 përqind të popullsisë totale në 1989. Shoqëria shqiptare është shumë sekulare dhe përkatësia fetare nuk është matur prej disa dekadash. Sipas vlerësimeve, rreth 70 përqind e popullsisë është Muslimane, rreth 20 përqind Ortodokse dhe rreth 10 përqind Katolike.

Arsimi në Shqipëri është i detyruar për fëmijët nga 6 deri në 14 vjet dhe është i lirë deri në moshën 18 vjet. Analfabetizmi ka qenë i ulët në kohët e komunizmit dhe ka vazhduar të bjerë, nga 7.3 përqind në 1989 në 1.4 përqind në 2001. Megjithatë, vetëm 4.8 përqind e popullsisë kishte mbaruar arsimin e lartë në 2001 dhe, sipas një studimi të 2001, rreth 40 përqind e të diplomuarëve shqiptarë ishin larguar nga vendi gjatë viteve 1990, ndërkohë që shumica e studentëve shqiptarë në Universitetet Perëndimore nuk kthehen në vend. Arsimi përbënte 3.4 përqind të PBB-së, ose 12.3 përqind të shpenzimeve totale shtetërore në vitin 2003.

Sistemi shëndetsor shqiptar vuan nga mungesa të theksuara kapaciteti (sidomos në zonat rurale), me 1.3 doktorë për 1000 banorë, me pak së gjysma e mesatares së BE-së prej 3 për 1000. Vdekshmëria foshnjore ra nga 45.4 për 1000 lindje në 1990 në 17.5 për 1000 në 2002, por mbetet më e larta në Evropë. Kujdesi shëndetsor financohet pjesërisht nga pagesa të detyruara dhe pjesërisht nga kontribute vullnetare të punonjësve dhe punëdhënësve. Shpenzimet e qeverisë për shëndetësinë në vitin 2002 përbënin 2 përqind të PBB-së, ndërsa parashikimi për vitin 2003 ishte 2.5 përqind.

2.1.5 Çështjet e punësimit

Sipas klasifikimit të Bankës Botërore, Shqipëria është një ekonomi me të ardhura të ulët në mesatare. Sektori privat përbën tani rreth 75 përqind të PBB-së (BERZH, Raporti i Tranzicionit, 2003) dhe punëson rreth 80 përqind të forcës punëtore (INSTAT). Fuqia punëtore në Shqipëri vlerësohet në rreth 1 milion vetë në çerekun e tretë të 2003 (rreth 35 përqind e popullsisë). Ky nivel i ulët shpjegohet me faktin së shumica e popullsisë në moshë prodhuese punësohet në Itali dhe Greqi. Megjithëse punësimi në sektorin jo-bujqësor po rritet, më shumë se 50 përqind e fuqisë punëtore haset në sektorin bujqësor. Papunësia e regjistruar në çerekun e tretë të 2003 pati një ulje të lehtë në 15 përqind. Sipas raportit “Biznesi në 2004” të Bankës Botërore, 33.4 përqind e të ardhurave në Shqipëri i detyrohen ekonomisë jo-formale.

Punëtorët kanë të drejtën e formimit të unioneve të pavarura. Dy federata të mëdha luajnë rol mbulues për unionet e vendit: Konfederata e Pavarur e Unioneve Tregtare (rreth 75,000 anëtare) dhe Konfederata Shqiptare e Unioneve Tregtare (rreth 100,000 anëtarë). Për shkak të rritjes së papunësisë të dy organizatat kanë pësuar një rënie në nivelin e anëtarësimeve. Disa unione nuk bëjnë pjesë në asnjë nga këto dy organizata. Asnjë union nuk ka përkatësi politike dhe qeveria nuk jep asnjë kontribut financiar për unionet. Për shkak të pozicionit të dobët të unioneve, grevat janë të rralla.

2.1.6 Reforma ligjore

Që në fillim të viteve 1990 kur Shqipëria nisi tranzicionin e saj drejt ekonomisë së tregur, korniza ligjore e vendit është zhvilluar së tepërmi. Megjithatë, ky proces është penguar ndjeshëm nga trazirat e brendëshme politike, shembja sistemit financiar në 1997, kriza e Kosovës dhe korrupsioni.

Shqipëria është një republikë parlamentare me një kushtetutë, e cila njeh ndarjen e detyrave, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe të drejtat e njeriut. Megjithëse korniza ligjore përcakton një gjyqësor të pavarur, mangësi të theksuara në trajnime, burime

dhe nivelet e ulëta të pagesës për gjykatësit e kanë bërë korrupsionin në gjyqe një fenomen të shpeshtë dhe kanë krijuar një mungesë besimi nga ana e komunitetit të biznesit. Të drejtat e njeriut dhe liritë personale, megjithëse respektohen e njihen në përgjithësi, shihen si problematike nga grupet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sidomos sa i përket mundësisë për të patur një proces të rregullt gjyqësor.

Shqipëria ka disa marrëveshje me BE në lidhje me dhënien e asistencës teknike dhe përafrimit të legjislativës. Zhvillime pozitive janë vënë re në afrimin e standarteve legjislative Shqiptare me ato të BE. Megjithatë, një shqyrtim i përgjithshëm i ligjit tregtar Shqiptar tregon se Shqipëria ende nuk ka zhvilluar një sistem legal që i përmbahet standarteve ndërkombëtare. Disa nga faktorët që kanë kontribuar në këtë dobësi janë pasiguria në regjimin ligjor për transaksionet e siguruara, standarte të ulëta menaxhimi dhe mangësi në legjislativën mbi tregjet financiare. Këto faktorë, të kombinuar me gjendjen e dobët të sistemit ligjor dhe respektit të ulët ndaj ligjit, kanë penguar të investorët e huaj dhe vendas.

Megjithatë, përmirësime në kornizën ligjore ka pasur: një shtesë e rëndësishme për Kodin e Procedurave Civile u kalua në Maj 2001; një ligji i ri kontratash u adoptua në 1999; Enti Rregullator për Telekomunikacionet u krijua në 1998 dhe një Autoritet rregullator për Energjinë Elektrike po funksionon që në 1999; në verën e 2003 u miratua një propozim për një ligj të ri për konkurrencën, i cili ofron norma të BE dhe parashikon krijimin e një autoriteti të pavarur për konkurrencën. Reforma ligjore gjithashtu u përmirësua me krijimin e një Gjyqi për Krimet e Rënda, i cili u hap në 1 Janar 2004. Ndërsa implementimi mbetet ende një sfidë, këto janë tregues inkurajues që Shqipëria po ecën drejt zhvillimit të një legjislativi i cili do të ndihmojë në tranzicionin drejt ekonomisë së tregut.

2.1.7 Çështjet e mjedisit

Problemet kryesore më të cilat përballet Shqipëria përfshijnë shpyllëzimin ilegal, mbi-kullotjen, ndotjen e ajrit dhe ujit dhe përpunimin e pakontrolluar të mbeturinave. Erozioni në brigje është rezultat i ndërtimeve pa leje dhe të pakontrolluara. Infrastruktura e vjetëruar dhe menaxhimi i papërshtatshëm i ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta sjell përkeqësimin e kushteve mjedisore. Përcaktimi i saktë i problemeve mjedisore që i kërcënohen Shqipërisë pengohet nga të dhënat e pamjaftueshme në shumë fusha, duke përfshirë informacion në nivel sektorësh mbi emisionet e gazrave dhe derdhjet e dëmshme.

Në një përpjekje për të zgjidhur këto sfida, Shqipëria ka zhvilluar një politikë mjedisore të përgjithëshme të mbështetur nga kuadri ligjor përkatës. Plani Kombëtar i Punës për Mjedisin, miratuar në 1994, u ndoq nga një sërë strategjish kombëtare mbi një numër fushash specifike, që përfshijnë përpunimin e mbeturinave, shëndetin kombëtar, biodiversitetin dhe pyjet. Krijimi i Ministrisë së Mjedisit në 2001 dhe zhvillimi i një Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit në 2002 konsolidoi procesin e reformës ligjore. Ligji i Vlerësimit të Pasojave mbi Mjedisin, miratuar së fundmi, ka ofruar një mekanizëm mbrojtës mjedisor të dobishëm në marrjen e vendimeve në investime. Gjatë 2003, Banka Botërore ndihmoi Shqipërinë në zhvillimin e një Strategjie Kombëtare Ujore dhe tani po ofron asistencë të vazhdueshme të bazuar në projekte në këtë sektor. Qeveria Shqiptare gjithashtu po punon me Bankën Botërore për të

rinovuar Planin Kombëtar të Punës për Mjedisin. Megjithatë kërkohet më shumë progres në këtë fushë dhe kapaciteti për të implementuar ligje dhe politika të reja lë shumë për të dëshiruar. Raporti i Mbikqyrjes Mjedisore (2002), prodhuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike Evropiane (UNECE), vëren se forcimi i kapaciteteve institucionale dhe zhvillimi i mëtejshëm i ligjit të procedurave mjedisore janë prioritete të vazhdueshme për Shqipërinë. Kapacitetet monitoruese të mjedisit të agjensive lokale kanë gjithashtu nevojë të përmirësohen.

Veprimtaria e BERZH-it në Shqipëri i përmbahet Politikës Mjedisore të Bankës dhe mbështet objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Projektet e BERZH-it kanë nevojë të strukturohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh regjimin aktual mjedisor si dhe çështje që përbëjnë problem të vazhdueshëm për mjedisin. Mund të jetë e përshtatshme që në sektorë me risk të mesëm ose të lartë për mjedisin, projektet të përfshijnë elementë të fortë vetë-monitorimi të mbështetur nga një monitorim më pro-aktiv nga stafi i vetë Bankës. Gjithashtu, aty ku është e mundur, bashkëpunimi teknik për të zgjidhur probleme të kapacitetit institucional mund të kryhet duke u koordinuar me IFI dhe donatorë të tjerë në mënyrë që të shmangen përsëritjet e panevojshme e të krijohet sinergji.

2.2 Mjedisi ekonomik

2.2.1 Kushtet makroekonomike për veprimtarinë e Bankës

Ekonomia Shqiptare ka përjetuar një rritje të shpejtë nga vitit 1998 (mesatarisht 9 përqind në vit gjatë periudhës 1998-2001). Megjithë një ngadalësim të përkohshëm në 4.7 përqind rritje të PBB-së në vitin 2002, ritmet e rritjes në 2003 arritën në rreth 6 përqind. Ri-vendosja e furnizimit me energji elektrike në gjysmën e dytë të vitit 2002 ka nxitur rritjen në aktivitetet industriale. Riparimet në sistemin e ujitjes, i cili ishte dëmtuar nga përmytjet, ndihmuan në ripërtëritjen e zhvillimit të bujqësisë. Megjithatë ekonomia Shqiptare vazhdon të cënohet nga ndërprerjet e energjisë elektrike, nga cilësia e ulët e infrastrukturës, duke përfshirë shërbimet civile dhe të transportit, dhe nga një mjedis i papërshtatshëm biznesi.

Politika e kujdeshme monetare e Bankës Qëndrore, e vënë në dukje nga një rritje e interesit nga 7 përqind në 8.5 përqind në 2002, ishte kritike në kufizimin e rrezikut të inflacionit. Inflacioni për vitin 2003, në rreth 3.3 përqind ishte brenda objektivit prej 2-4 përqind dhe lejoi uljen e interesave në 6.5 përqindëshin e mëparshëm. Banka Qëndrore vepron me një regjim të menaxhuar të kursit të këmbimit (*managed float*). Ndërhyrjet në tregun valutor ishin relativisht të mëdha. Banka e Shqipërisë bleu rreth 46 milionë Dollarë amerikanë valutë nga Janari deri në Gusht 2003 për të përmbajtur presionin për mbiçmim. Si rezultat, Leku mbeti i qëndrueshëm ndaj Euros dhe u mbiçmua ndaj Dollarit Amerikan në vitin 2003. Stabiliteti i monedhës vendase bazohet në hyrje valute të mëdha si pasojë e remitançave, një sasi investimesh direkte të huaja (FDI), rritje në eksporte dhe inflacion relativisht të ulët.

Defiçiti buxhetor, megjithëse mbetet i lartë po ulet gradualisht, nga më tepër së 11 përqind të PBB-së në vitin 1999 në rreth 5.6 përqind të PBB-së (pa llogaritur grantet)

në vitin 2003¹. Ulja e defiçitit fiskal në 2003 vjen nga rritjet në të ardhura dhe kursime në zërat subvencione dhe shpenzime për mirëmbajtje dhe personel. Të ardhurat nga taksat dhe doganat, megjithëse janë rritur ndjeshëm, përsëri nuk arrijnë nivelet e buxhetuara në mënyrë ambicioze për shkak të problemeve me korrupsionin, evazionin tatimor dhe raportime të pasakta. Borxhi publik vlerësohet në rreth 61.3 përqind të PBB-së në vitin 2003, pra tregon ulje nga nivelet prej 67.7 përqind në vitin 2001 dhe 63.2 përqind në vitin 2002. Përbërësi i brendshëm i borxhit prej 38 përqind të PBB-së mbetet ende një shqetësim i rëndësishëm, kryesisht për shkak të normave relativisht të larta të interesit. Kthimi mbi bonot e thesarit tremujore ra në rreth 7.5 përqind dhe ai mbi bonot e thesarit njëvjeçarë nën 10 përqind në fund të vitit 2003.

Borxhi i jashtëm llogaritet në rreth 23.3 përqind të PBB-së (1.4 miliardë Dollarë amerikanë). Pagesa vjetore e borxhit të jashtëm ishte rreth 6.4 përqind e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2002 dhe pritet të arrijë një vlerë maksimale prej 10 përqind në vitin 2010. Kjo rritje afatmesme është rrjedhojë e pagesave më të mëdha të borxhit bilateral në vitin 2004, riskedulimit të borxhit të prapambetur dhe më pak borxhe me interesa të zbutura. Borxhi i jashtëm duket i menaxhueshëm sidomos po të kihet prasysh hyrja e qëndrueshme e remitancave në vend (700 milionë Dollarë amerikanë në vitin 2003). Shqipëria ka riskeduluar suksesshëm borxhin e prapambetur ndaj anëtarëve të Klubit të Parisit (borxhi i prapambetur u pakësua nga 9.8 përqind e PBB-së në vitin 2001 në 2.3 përqind të PBB-së në vitin 2003) dhe ka nënshkruar marrveshje për ristrukturimin e borxhit me një numër vendesh ish-komuniste. Ndërsa kujdesi mbetet i nevojshëm, kapaciteti huamarrës nuk duket të përbëjë një pengesë të rëndësishme për kredi të Bankës në mbështetje të projekteve me logjikë ekonomike që kërkojnë garanci shtetërore.

Defiçiti i llogarisë korrente, i ndikuar kryesisht nga kërkesa e lartë për konsum ndaj mallrave të importit, arriti në vitin 2003 në rreth 8.5 përqind të PBB-së (me përjashtim të transfertave zyrtare)². Kjo shifër është më e ulët se 9.1 përqind e vitit 2002, por mbetet mbi nivelet e viteve 1998-2001. Rezervat ndërkombëtare bruto u rritën në 2003 në rreth 874 milionë Dollarë amerikanë dhe mbulojnë rreth 4.4 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve. Defiçiti tregtar, 1.371 miliardë në vitin 2003, mbetet konstant si përqindje ndaj PBB-së në rreth 23 përqind. Defiçiti është strukturor. Eksportet mbulojnë vetëm një të katërtën e importeve dhe kufizohen në produkte me kërkesë të lartë për fuqi punëtore, si veshjet dhe prodhimi i këpucëve. Financohet kryesisht me remitancat e Shqiptarëve që punojnë jashtë shtetit, prurje të moderuara nga investimet e huaja dhe asistencë financiare e huaj. Investimet e huaja direkte (192 milionë Dollarë amerikanë në vitin 2003) mbeten nga më të ultat në rajon në përfrimë.

Në afatin e shkurtër, rritja vjetore e PBB-së pritet të jetë rreth 6 përqind me inflacion vjetor prej rreth 3 përqind. Sipas parashikimeve të FMN-së, investimet e huaja direkte pritet të rriten në më tepër se 200 milionë Dollarë amerikanë në vit. Reformat administrative dhe përmirësimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat pritet të ulin defiçitin buxhetor në më pak se 5 përqind të PBB-së. Rritja e eksporteve pritet të ulë

¹ Defiçiti qëndror i qeverisë bashkë me grantet ishte rreth 5 % i PBB-së në 2003. Grantet e mbështetjes buxhetore pritet të mbeten stabil në afatin e mesëm.


² Defiçiti i llogarisë korrente bashkë me transfertat zyrtare ishte rreth 6.1 % e PBB-së në 2003. Transfertat zyrtare, të shpenzuara kryesisht në investime kapitali, pritet të mbeten në rreth 2% të PBB-së në afatin e mesëm.

defiçitin tregtar, duke rezultuar në një ulje graduale të defiçitit të llogarisë korrente. Rreziqet përfshijnë kërcënime ndaj stabilitetit politik, furnizimin me energji elektrike akoma të pasigurt, rritje të ngadaltë ekonomike të partnerëve tregtarë, korrupsionin dhe implementimin e ngadaltë të reformave strukturore.

2.2.2 Klima e investimeve

Perceptimi për klimën e biznesit në Shqipëri është përmirësuar nga 1999 (shih fig. 1), megjithatë sipërmarrjet private, dhe veçanërisht SME-të, vazhdojnë të hasin shumë pengesa. Këto pengesa, sipas studimit të BEEPS në 2002, u ulën në disa fusha, por u vu re shumë pak përmirësim në uljen e korrupsionit dhe rritjen e standarteve të gjyqësorit.

TAB 1: Pengesa për biznesin në Shqipëri: 1999 dhe 2002



Vlerat kalojnë nga 1 në 4, ku 1 tregon se nuk ka pengesa për rritjen e biznesit dhe operacioneve dhe 4 tregon pengesa madhore. Ekstremiteti i çdo aksi paraqet një vlerë të barabartë me 4, pra një klimë të disfavorshme për investime.

Burimi: Pyetësori mbi Mjedisin e Biznesit dhe Performancën e Sipërmarrjeve. (BEEPS), 1999 dhe 2002

Zhvillimi i sektorit privat dhe investimi i huaj direkt (FDI) pengohet jo vetëm nga infrastruktura e dëmtuar dhe problemet kronike me energjinë, por gjithashtu nga një administrim i dobët dhe korrupsion masiv, të cilët çojnë në mos-zbatim të dispozitave ligjore dhe konkurrencë të pandershme si nga ekonomia jo-formale ashtu edhe nga praktikatat ilegale të kompanive të regjistruara (kontrabanda, evazion tatimor, importe ilegale, falsifikime dhe prodhim i palicënsuar). Qeverisja e dobët e kompanive, në nivelet makro dhe mikro, mungesa e aftësive menaxhuese si edhe një sistem bankar i pazhvilluar janë pengesa të tjera për zhvillimin e ekonomisë private dhe investimeve të huaja direkte. Reformimi i sistemit gjyqësor, forcimi i ligjit dhe rendit publik, lufta ndaj korrupsionit dhe thellimi i reformave në administratën publike mbeten sfida kyçe për qeverinë në periudhën afat-mesme. Çështje të tjera të rëndësishme përfshijnë implementimin e ligjit të ri për konkurrencën bashkë me ngritjen e një Autoriteti të pavarur për Konkurrencën, forcimin dhe rritjen e transparencës së kuadrit ligjor për industrinë, futjen e ligjeve të reja për sigurimet dhe forcimin e kuadrit ligjor financiar dhe për mbrojtjen e konsumatorëve. Gjithashtu mbetet thelbësor zhvillimi i kapacitetit të mtejshëm për të absorbuar ndihmën ndërkombëtare dhe implementuar projektet për sektorin publik. Përmirësimet institucionale janë të nevojshme si për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë qeveritare ashtu edhe për arritjen e kapacitetit implementues të nevojshëm për finalizimin e negociatave mbi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në.

2.2.3 Akcesi në kapital

Megjithë përmirësimet e fundit në sektorin bankar dhe konfidencën e rritur në sektorin financiar treguar nga rritja e ndjeshme e depozitave, mundësia për financim për ndërmarrjet Shqiptare nga burime formale mbetet shumë e kufizuar. Kredi vendas për sektorin privat në fund të vitit 2002 ishte nën 5 përqind të PBB-së, shumë më poshtë se në vende të tjera të rajonit si Bosnja e Hercegovina dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Provat e marra nga pyetësorët e BEEPS në vitin 2002 tregojnë se SME-të mbështeten shumë në fonde të brendshme dhe remitanca nga jashtë për të financuar investimet e reja. Privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe vendimi i saj për të dhënë hua për sektorin privat, në vend që të kanalizojë të gjithë depozitimet në monedhën vendase në bono shtetërore, mund të rrisë furnizimin me kredi të sektorit privat. Megjithatë, rregulloret shtrënguese të Bankës Qëndrore për huadhënien e bankave private, vendosur për herë të parë pas kolapsit të skemave piramidale në vitin 1997, kufizojnë mundësitë huadhënëse dhe imponojnë një politikë shumë konservative për bankat tregtare, duke përfshirë edhe kërkesa kolaterali shumë të larta.

Bursa e Tiranës e krijuar në vitin 1996, veprimi vetëm me bono thesari dhe u mbyll më vonë në fillim të vitit 2000. Megjithëse u rihap kohët e fundit, nuk është plotësisht funksionale dhe influenca e saj si burim kapitali të freskët për kompanitë pritet të jetë shumë e ulët. Mosrespektimi i kontratave, mbrojtja e kufizuar e të drejtave të aksionerëve dhe një gjyqësor i dobët gjithashtu pengojnë zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

3. PROGRESI DHE SFIDAT E TRANZICIONIT

Megjithë problemet e brëndshme politike, Shqipëria mbetet e angazhuar ndaj reformave dhe në disa aspekte, si liberalizimi i tregtisë dhe privatizimi i ndërmarrjeve të vogla, ajo është në krye të tranzicionit në rajon (shih tab. 3.1). Vendi ka përfunduar shumicën e privatizimit të sektorit të vogël, dhe ka lëvizur shumicën e aseteve në banesa, transport dhe shitje me pakicë në sektorin privat, i cili tani përfaqëson rreth 80 përqind të punësimit. Pas një ngadalësimi të përkohshëm, Shqipëria arriti gjithashtu të rivitalizojë privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha. Në Korrik 2003, BERZH dhe IFC blenë secila nga 19 përqind të aksioneve në kompaninë e madhe shtetërore të sigurimeve INSIG dhe në Dhjetor 2003 qeveria aprovoi shitjen e bankës të fundit, dhe më të madhe në vend, në pronësi të shtetit, Bankës së Kursimeve, në favor të Raiffeisen Group. Në përpjekje për të mbështetur rritjen e investimeve të huaja direkte të palidhura me privatizimet, qeveria krijoi në Dhjetor 2002 një Agjensi të Nxitjes të Investimeve të Huaja, e cila synon të bëhet një agjensi “one stop shop”.

Tab 3.1: Tregues të tranzicionit në disa vende të Evropës Jug-Lindore, 2003

	Shqipëria	Bosnia dhe Hercegovina	IRJ Maqedoni	Serbia dhe Mali i Zi
Liberalizimi i çmimeve	3.7	4.0	4.0	4.0
Liberalizimi i eksp. dhe tregtisë	4.3	3.7	4.3	3.3
Privatizimi në shkallë të vogël	4.0	3.0	4.0	3.0
Privatizimi në shkallë të madhe	2.3	2.3	3.0	2.3
Reforma e sipërmarrjeve	2.0	2.0	2.3	2.0
Politikat e konkurrencës	1.7	1.0	2.0	1.0
Infrastruktura	2.0	2.3	2.0	2.0
Sektori bankar	2.3	2.3	3.0	2.3
Institucione financiare jo-bankare	1.7	1.7	1.7	2.0

Indeksi kalon nga 1, që tregon pak ose aspak progres në 4.3 që tregon standarte të ngjashme me ekonomitë e përparuara

Burimi: EBRD Transition Report, 2003

Sfidat kyçe të tranzicionit ku Banka mund të ndihmojë në Shqipëri janë:

3.1 Zhvillimi i sektorit privat

Sfidat më të mëdha në zhvillimin e sektorit privat, siç tregohet me sipër, lidhen me klimën e papërshtatshme për investime dhe nivelin e korrupsionit. Prioritetet bazë përfshijnë forcimin e kuadrit institucionale për nxitjen e investimeve të huaja dhe SME-ve, përmirësimin e zbatimit të ligjeve tregtare, si dhe reduktimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përmirësimi i mëtejshëm në mbledhjen e detyrimeve tatimore dhe doganore duke pakësuar evazionin fiskal dhe ekonominë jo-formale do të ndihmonin në sigurimin e një fushe veprimi me kushte të barabarta midis firmave private.

Megjithë kushtet jo të favorshme, ekzistojnë kompani private lokale (agrobiznesi dhe industri të tjera) që kanë arritur të mbijetojnë gjatë krizave të ndryshme dhe të konkurrojnë mirë në nivelin kombëtar, dhe në një shkallë më të ulët në tregjet e eksportit. Këto kompani mund të përfitonin nga financime afatmesme ose afatgjata, direkte ose indirekte (nëpërmjet bankave lokale), për të investuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Në sektorin e telekomunikacioneve, privatizimi i kompanisë celulare shtetërore, AMC, dhe dhënia e licenses së veprimit për Vodafonin, ka krijuar një treg të telefonisë celulare mjaft kompetitiv, i cili po zgjerohet me hapa të shpejtë. Megjithatë, përpjekjet e pasuksesshme të qeverisë për privatizimin e Albtelekomit, operatorit kombëtar të telefonisë fikse, kanë kufizuar zhvillimin në këtë fushë dhe ky treg ka mbetur tashmë mjaft prapa vendeve të tjera të rajonit. Qeveria është përpjekur të nxisë zhvillimin në zonat rurale duke dhënë liçenca për operatorë të vegjël lokalë të telefonisë, por ky veprim ka pak mundësi të sjellë ndikim të ndjeshëm në të ardhmen e afërt. Progres i mëtejshëm nevojitet në reformën ligjore dhe rregullatore. Qeveria duhet të ndërmarrë hapa për implementimin e një kuadri të qëndrueshëm ligjor dhe rregullator për sektorin, për të nxitur konkurrencën e mëtejshme në një treg të liberalizuar. Është e domosdoshme të përmirësohet transparenca dhe performanca financiare e Albtelekomit për të pasur një privatizim të suksesshëm.

Në sektorin e burimeve natyrore, Shqipëria duhet të përfundojë privatizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve të naftës dhe gazit dhe të rrisë pjesëmarrjen e sektorit privat e të nxisë investimet e huaja. Një sfidë madhore është inkurajimi i bashkëpunimit rajonal dhe sigurimi i transparencës dhe stabilitetit në projektet për transportin e naftës dhe gazit për të shmangur ngushticat (*bottlenecks*) në transport dhe për të siguruar akses kompetitiv në treg. Për më tepër, Shqipëria duhet të përmirësojë kuadrin rregullator dhe institucional të sektorit, të vendosë standarte të larta biznesi, transparence, qeverisjeje të ndërmarrjeve dhe mbrojtjeje të mjedisit.

3.2 Sektori financiar

Mundësi për financim është një kërkesë thelbësore për zhvillimin e sipërmarrjeve private. Pa kreditim, kompanitë nuk mund të rriten dhe zhvillohen, dhe idetë e reja mund të mos kenë kurrë mundësi të zbatohen. Siç u diskutua në seksionin 1 më sipër, ndërsa ekzistojnë 16 banka që veprojnë në treg, vetëm gjysma e tyre janë disi aktive në kreditimin e ekonomisë, pra niveli i ulët i ndërmjetësimit financiar mbetet një pengesë e rëndësishme për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri. Rritja e kreditimit nga bankat vendase për sektorin privat, veçanërisht për SME-të, është një sfidë e madhe për sektorin financiar. Brenda të njëjtit kuadër, një sfidë tjetër e rëndësishme, duke parë eksperiencën e kufizuar huadhënëse, është rritja e aftësive të bankierëve lokale, sidomos në vlerësimin e kredive afatgjata.

Sfida të tjera përfshijnë promovimin e transaksioneve jo-kesh, forcimi i të drejtave të pronësisë, përmirësimi i regjistrave të tokës dhe kadastrave për të lehtësuar përdorimin e pronave si kolaterale nga firmat lokale, zbatimi i detyrimeve kontraktuale, dhe mundësi më të mëdha për të marrë informacion mbi kredimarrësit. Ulja e barrierave administrative dhe kostove për transferimin e fitimeve të emigrantëve nga jashtë në sistemin bankar shqiptar është gjithashtu e rëndësishme për rritjen e mundësive të financimit të investimeve të reja.

Nxitja e instrumenteve të reja financiare (p.sh futja e lizingut) dhe rritja e efikasitetit dhe përmirësimi i standarteve të tregut në sektorin e sigurimeve nëpërmjet përfundimit të privatizimit të INSIG-ut nga një investitor strategjik janë sfidat më të mëdha për zhvillimin e institucioneve financiare jo-bankare në Shqipëri.

3.3 Sektori i infrastrukturës

Megjithë investimet në rritje, infrastruktura është ende shumë e rrënuar si pasojë e mungesës kronike të investimeve dhe gjendja e saj e varfër përbën një pengesë të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të sipërmarrjeve private. Përmirësimet në infrastrukturë janë thelbësore për integrimin rajonal dhe Evropian të Shqipërisë. Komercializimi dhe privatizimi i enteve publike janë gjithashtu thelbësore në tërheqjen e investimeve të huaja, dhe rrisin eficiencën dhe performancën e shërbimeve publike.

Energjitika– Situata në sektorin e energjitikës nga fillimi i procesit të tranzicionit është përkeqësuar me ritme të shpejta. Humbjet teknike dhe jo-teknike (mospagimi ose vjedhja e energjisë) janë rritur ndjeshëm pas krizës së vitit 1997, duke arritur në mbi 60 përqind të furnizimit me energji. Megjithë përmirësimet, qeverisja e KESH-it ka mbetur shumë e dobët, me drejtues me fuqi dhe përgjegjësi të kufizuara, me një strukturë të vertikalisht të integruar që përmbledh shumë funksione dhe me sisteme informacioni të brendshme të mangëta. Një sfidë thelbësore është komercializimi i plotë i KESH-it, duke përfshirë ndarjen e kompanisë sipas funksioneve, reduktimin e humbjeve nga vjedhjet dhe mospagimi, dhe privatizimin gradual të aseteve të shpërndarjes dhe prodhimit.

Megjithëse Shqipëria mund të përfitojë nga hidroenergjitika me kosto të ulët, një varësi e tepërt nga hidroenergjitika e vendos furnizimin elektrik në rrezik gjatë periudhave me rreshje të ulta, pra nevojitet diversifikimi i furnizimit me energji.

Integrimi rajonal është gjithashtu një sfidë e rëndësishme, sepse do të lejojë një eficiencë më të madhe në planifikimin dhe përdorimin e aseteve. Standartet për integrim rajonal janë vendosur nga procesi i Athinës për krijimin e një Tregu Rajonal të Energjisë për Evropën Juglindore (“SEEREM”). Nën procesin e Athinës, vendet e Evropës Juglindore kanë marrë përsipër të krijojnë një treg plotësisht operativ rajonal (me kufij të hapur) deri në vitin 2007 dhe kjo është materializuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të Athinës, i cili është në harmoni me direktivat e BE-së për Elektricitetin.

Transporti – Disa institucione financiare (duke përfshirë BERZH-in) dhe donatorë bilateralë kanë dhënë financim për sektorin, por ka ende shumë fusha të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të shpejtë. Sektori ka nevojë për një rehabilitim dhe modernizim të madh, veçanërisht në kontekstin e korridoreve të transportit Lindje-Perëndim dhe Veri-Jug (rrugë, porte, hekurudha) dhe aviacion civil. Një forcim institucional dhe administrativ si edhe alokime më të mëdha buxhetore nevojiten për riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, në vijim të nevojës urgjente për përmirësimin e sigurisë në rrugë. Rritja e përfshirjes së sektorit privat në shërbimet në porte, aeroporte dhe hekurudha është gjithashtu një sfidë thelbësore, e cila mund të përfitojë nga përfshirja e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Sfida kryesore në sektorin e aeroporteve do të jetë privatizimi i suksesshëm i Aeroportit të Tiranës mbi baza ekonomike dhe transparente. Banka tashmë ka ndikuar pozitivisht në strukturimin e procesit të tenderimit për privatizim.

Infrastruktura bashkiake dhe mjedisore – Sektori vuan nga mungesa e investimeve dhe mirëmbajtjes. Shërbimet bashkiake si furnizimi me ujë të pijshëm, ujërat e zeza, transporti urban dhe përpunimi i mbetjeve të ngurta kërkojnë investime dhe përmirësime të mëdha. Megjithatë, shumica e investimeve duhet të shoqërohet me reforma institucionale, ligjore dhe rregullatore për të siguruar që bashkitë të kenë burime të parashikueshme të ardhurash përkundrejt të cilave mund të sigurojnë financime. Gjithashtu duhet të ndiqen parimet e kthimit të investimit në nivel kompanie.

4. ORIENTIMET STRATEGJIKE

4.1 Prioritetet e bankës për periudhën e strategjisë

Banka është në pozicion të mirë dhe plotësisht e vendosur për të ndihmuar Shqipërinë të kalojë sfidat e saj të tranzicionit. Gjatë periudhës së strategjisë, Banka do të mbështesë përpjekjet e qeverisë drejt kryerjes së reformave dhe përmirësimit të klimës investuese në vend. Banka do të kërkojë në mënyrë të kujdesshme balancimin e investimeve të reja për sektorin privat me mbështetjen për infrastrukturën publike themelore si faktorë kyç për promovimin e investimeve të huaja direkte. Buxheti aktual i projekteve të ardhshme arrin në rreth 127 milionë Euro. Gjithashtu do t'i jepet prioritet implementimit të shpejtë dhe të suksesshëm të projekteve ekzistuese, veçanërisht atyre në sektorin e infrastrukturës. Gjithashtu, banka do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme operationale:

- Zhvillimi i sektorit privat me anë të investimeve direkte në ndërrmarjet private ose të privatizuara, dhe atje ku është e mundur mbështetja e privatizimeve të ardhshme.
- Forcimi i sektorit financiar dhe rritja e ndërmjetësimit financiar si një faktor kyç për zhvillimin e SME-ve.
- Mbështetje për investime prioritare në infrastrukturë, veçanërisht në sektorët e energjitikës dhe transportit.

Në mënyrë që të maksimizohet impakti i tranzicionit, këto veprime do të shoqërohen me dialog të afërt me qeverinë mbi subjekte kyçe si kuadret rregullatorë të infrastrukturës, veçanërisht në sektorin e energjitikës. Banka do të vazhdojë të ketë një dialog konstruktiv me komunitetin e biznesit lokal dhe investorët e huaj. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me bashkë-financues dhe donatorë bilateralë me synim sigurimin e financimeve të zbutura ose granteve për projektet e infrastrukturës publike.

Të gjitha operationet e BERZH në Shqipëri do të vazhdojnë të respektojnë Politikën për Mbrojtjen e Mjedisit të Bankës dhe do të përfshijnë, aty ku është e mundur, Plane e Veprimi për Mbrojtjen e Mjedisit, në përputhje me mandatin e Bankës për mbështetjen e projekteve të investimit që ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit.

Për dy vitet e ardhshëm, Banka do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme specifike:

4.2 Zhvillimi i sektorit privat

Mbështetja e sektorit privat ka qenë në qendër të punës së Bankës në Shqipëri dhe sot rreth 49 përqind e portofolit është në sektorin privat. Banka do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e sektorit privat gjatë periudhës së strategjisë nëpërmjet investimeve direkte në sektorin privat, përfshirjes më të gjerë në agro-biznes dhe mbështetjes së privatizimeve (telekomi).

Objektivat operative

Banka do të synojë të mbështesë zhvillimin e sektorit privat me anë të përfshirjes në :

Indstria e Përgjithshme dhe Agro-Biznes - Banka do të mbështesë direkt projekte private të kompanive ekzistuese dhe të reja. Banka, gjithashtu do të shtojë përpjekjet e saj për të mbështetur zhvillimin e sektorit të agro-biznesit duke ndihmuar kompanitë private dhe SME-të, në mënyrë direkte ose indirekte. Prioritetet operative të Bankës për periudhën e strategjisë përfshijnë:

- Financimi i rehabilitimit dhe zgjerimit të Fabrikës së Çimentos në Fushë Krujë, e cila do të zëvendësonte importet e çimentos në Shqipëri.
- Financimi i një fabrikë për paketimin e ushqimeve për një klient ekzistues të Bankës, i cili është aktualisht prezent në rajon.
- Banka është gjithashtu duke diskutuar me dy konsorciume të ndryshme për financimin e një investimi të mundshëm fillestar në industrinë e birrës në Shqipëri. Konsultimet janë në proces dhe pritet që investimi të përfshijë një investitor të rëndësishëm strategjik në këtë sektor si aksioner dhe si partner drejtues.
- Gjithashtu, Banka do të intensifikojë diskutimet që po bëhen tashmë me banka të ndryshme lokale për të bashkë-financuar kreditimin afatshkurtër në bazë mallrash konsumi.
- Do të shqyrtohen mundësi të mëtejshme në sektorin e burimeve natyrore (tubacione rajonale – nëse materializohen) dhe në sektorin tregtar të pasurive të paluajtshme.

Telekomunikacionet – Banka do të vazhdojë të kërkojë mundësi për të nxitur zhvillimin e sektorit me anë të:

- Shqyrtimit të asistencës së mëtejshme teknike për të ndihmuar në implementimin e një kuadri modern ligjor dhe rregullator, kushtëzuar nga dedikim dhe veprime të qarta të qeverisë për të zbatuar ndryshimet e nevojshme.
- Shqyrtimit për të financuar Albtelekomin pas ose para privatizimit, kushtëzuar nga hapat e marra për përmirësimin e qeverisjes së ndërrmarjes, transparencës dhe treguesve operativë dhe financiarë të kompanisë sipas standarteve ndërkombëtare.

Në frontin e dialogut mbi politikat, do të shqyrtohet potenciali për të ofruar ndihmë teknike për mbështetjen e forcimit institucional dhe zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet përmirësimit të fokusuar të kuadrit ligjor dhe administrativ.

4.3 Sektori financiar

Me anë të investimeve në kapital, Banka ka pasur një ndikim të fuqishëm fillestar në sektorin financiar në Shqipëri. Faktorë të jashtëm (kriza financiare e 1997, një klimë e papërshtatshme për investimet) dhe faktorë të brendshëm (mungesë sponsorësh ose menaxhim i dobët, vonesa në privatizimin e Bankës së Kursimeve) kanë penguar zhvillimin e mëtejshëm të sektorit dhe kanë kufizuar aftësinë e bankave për të kanalizuar në mënyrë eficiente fondet drejt ekonomisë (me disa përjashtime si Banka ProCredit). Në mënyrë që të shtohet ndërmjetësimi financiar dhe t'i shërbehet më mirë

nevojave të SME-ve dhe sektorit të sipërmarrjeve në përgjithësi, janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për përshtatjen e rolit të Bankës në sektorin financiar. Banka gjithashtu do të vrojtojë aktivisht edhe sektorin financiar jo-bankar.

Objektivat operative

Banka do të fokusohet në:

- Shqyrtimin e mundësisë për të përdorur eksperiencën e fituar në vendet kandidatë për anëtarim në BE në ngritjen e linjave të dedikuara për kreditimin e SME-ve shoqëruar me asistencë teknike, financuar nga BE ose donatorë të tjerë, dhe bonuse të lidhura me arritjen e objektivave sasiorë të paracaktuar në lidhje me portofolin e kredive.
- Krijimin e mjeteve të ndarjes së riskut të financuara nga donatorët për bankat lokale për të mbështetur dhe shtuar aktivitetin e tyre huadhënës (një parim i ngjashëm po vepron tashmë në Serbi dhe Malin e Zi me mbështetjen e Italisë).
- Shqyrtimin e mundësisë për të mbështetur nëpërmjet instrumentave të reja Bankën e Kursimeve dhe Bankën Kombëtare Tregtare, sapo të vendosen investoret e rinj strategjikë.
- Vazhdimin e mbështetjes së zhvillimit të ProCredit Bank. Është parashikuar një rritje e mëtejshme e kapitalit për këtë periudhë të strategjisë, për të mbështetur rritjen e bankës.
- Nxitjen dhe mbështetjen e konsolidimit të sektorit bankar nëpërmjet bashkimeve dhe blerjeve midis bankave lokale.
- Mbështetjen e privatizimit të plotë të INSIG-ut me anë të një ristrukturimi të suksesshëm nën skemën e investimit para privatizimit.

Banka do të synojë të bashkërendojë investimet e saj me asistencë teknike përkatëse, aty ku është e mundur, për të forcuar kapacitetet e bankave lokale në këto produkte. Banka, do të shqyrtojë gjithashtu edhe mundësinë e mbështetjes së kuadrit ligjor për të lejuar futjen e instrumentave të reja (si lizingu), kushtëzuar nga një angazhim i përshtatshëm nga ana e autoriteteve përkatëse.

4.4 Sektori i infrastrukturës

Zhvillimi i infrastrukturës do të jetë një prioritet kyç për periudhën e ardhëshme. Në dhënien e mbështetjes për infrastrukturën në sektorin publik, Banka do të punojë shumë afër me bashkë-financues dhe donatorë potencialë në mënyrë që të kufizojë rritjen e borxhit publik të shtetit, si edhe të mobilizojë mbështetje për të adresuar problemet e kapacitetit institucional.

Objektivat operative

Energjitika – Banka do të fillojë projekte të cilat adresojnë çështje teknike të sektorit të energjitikës, dhe mbështesin përpjekjet ristrukturuese të sektorit të energjisë elektrike dhe integritit të tij rajonal. Banka është përfshirë tashmë në dy projekte në fushën e transmetimit dhe shpërndarjes, të cilët kanë nisur të disbursohen rregullisht. Ndërsa implementimi i këtyre projekteve do të vazhdojë të jetë një prioritet kyç për Bankën, prioritetet e tjera rradhiten më poshtë:

- Banka do të fokusohet në anën e prodhimit të energjisë elektrike, me një projekt për ndërtimin e një termoçentrali. Një studim fizibiliteti, ka konfirmuar se një projekt për ndërtimin e një termoçentrali me fuqi të instaluar prej rreth 100 MW, i vendosur në brigjet e Shqipërisë jug-përëndimore, do të ishte hapi më i mirë për të reduktuar varësinë nga hidroenergjitika (dhe optimizimin i përdorimit të saj), për të ulur humbjet në rajonin e çentralit dhe të arritur kërkesat e caktuara të rezervave për integrim në UCTE. Banka po konsideron bashkë-financimin e projektit (deri në 40 milionë Euro), me Bankën Botërore dhe Bankën Evropiane të Investimeve.
- Banka do të shqyrtojë investime të mëtejshme në transmetim me synim ndërtimin e një linje ndërlidhëse transmetimi rajonale me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe një zgjerim të mundshëm edhe me Italinë, një projekt ky i cili do të sillte përfitime edhe më gjerë në rajonin e Evropës jug-lindore. Banka ka në plan të nisë një studim fizibiliteti për këtë investim në të ardhmen e afërt.
- Në sektorin privat, Banka është duke monitoruar procesin për ndërtimin e mundshëm të një çentrali hidroenergjitik të ri (sipas një skeme BOOT) në Shqipërinë jugore, të dedikuar për eksportimin e energjisë drejt Italisë.

Paralelisht, Banka do të vazhdojë të mobilizojë asistencë të përshtatshme teknike për KESH-in për mbështetjen e forcimit të vazhdueshëm institucional dhe përmirësimin e qeverisjes. Nëpërmjet dialogut mbi politikën, Banka do të vazhdojë të mbështesë ristrukturimin e KESH-it dhe reformën në sektor, duke pasur konsideratën e duhur për mbrojtjen e mjedisit.

Transporti – Banka ka qenë aktive edhe në sektorin e rrugëve në Shqipëri, duke financuar rehabilitimin e një segmenti prej 30 Km të Korridorit VIII Lindje-Perëndim. Zbatimi i rregullt i këtij projekti do të mbetet një prioritet për Bankën. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, Banka është duke shqyrtuar mbështetjen për projektet e mëposhtme:

- Roli i Bankës në sektorin rrugor do të vazhdojë me anë të financimit, bashkë me Bankën Evropiane të Investimeve, të rehabilitimit dhe rindërtimit të një segmenti 82 Km të rrjetit kryesor rrugor midis Fierit dhe Tepelenës, i cili është pjesë e aksit Veri-Jug, dhe çon në kufirin me Greqinë. Përmirësimi i këtij rrjeti rrugor përbën një prioritet të lartë për qeverinë dhe nënshkrimi pritet të kryhet në fund të vitit 2004. Projekti (Fier-Tepelenë) do të krijojë mundësinë për të lançuar një reformë më të gjerë në sektorin rrugor, duke u përqendruar mbi politikën sektoriale më tepër se mbi çështjet teknike. Ky investim do të lidhet me përmirësime në financimin e sektorit rrugor (fonde për mirëmbajtjen e rrugëve dhe rikuperimin e kostove) dhe reformën institucionale.
- BERZH-i po mbështet aktualisht dy nga konkurrentët për konçesionin e aeroportit të Tiranës. Përpyekjet e bankës kanë qenë thelbësore në nxitjen e ndryshimeve në procesin e tenderimit për të pasur një vlerësim më transparent në krahasimin e ofertave. Konçesioni pritet të jepet në mes të vitit 2004.
- Në sektorin e porteve, Banka do të vazhdojë të inkurajojë komercializimin, ristrukturimin dhe transparencën nëpërmjet përfshirjes së saj në master planin e Portit të Durrësit, dhe do të shqyrtojë gjatë periudhës së kësaj strategjie mundësi të bashkëfinancimit me BEI-n dhe BE-në të projekteve të lidhura me integrimin dhe zhvillimin rajonal, si terminali i trageteve në portin e Durrësit.

- Banka ka identifikuar si një projekt potencial ndërtimin e një terminali për depozitimin e naftës dhe gazit në portin e Vlorës, nëse qeveria miraton konçesionin përkatës. Projekti sponsorizohet nga një kompani e huaj private e cila i ka kërkuar Bankës financim. Projekti do të ofrojë depozita për shpërndarësit lokale të karburantit dhe gazit natyror..

Infrastruktura bashkiake dhe mjedisore – Zhvillimi i një projekti në sektorin e infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore do të jetë një objektiv i ri i Bankës gjatë periudhës së kësaj strategjie.

- Investimet fillestare do të fokusohen në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, ku rekuperimi i kostove është zakonisht i mundshëm me anë të zbatimit të reformës të përshtatshme të tarifave, e cila gjithashtu do të sjellë një përdorim më eficient të ujit të pijshëm.
- Transporti urban dhe investimet në përpunimin e mbetjeve të ngurta do të shqyrtohen nga rasti në rast. Banka do të shohë mundësinë e fillimit të projekteve pilot nën garanci shtetërore dhe do të shqyrtojë financimin me garanci në nivel lokal në varësi të cilësisë së kompanisë dhe llojit të mbështetjes nga autoritetet qendrore dhe lokale.
- Shqipëria ka burime ujore të bollshme dhe me cilësi të lartë, veçanërisht në jug të vendit, të cilat do të përfitonin nga një strategji e përgjithshme për menaxhimin e ujit. Projekte për shitjen e ujit në vendet fqinje që kanë deficiente ujore (Greqia, Italia) do të shqyrtohen në varësi të konfirmimit të mjaftueshmërisë së rezervave afatgjata nga studimet hidro-geologjike.

5. BASHKËPUNIMI ME DONATORË DHE INSTITUCIONE TË TJERË

Banka do të vazhdojë të ndjekë objektivat e propozuara në bashkëpunim të afërt me donatorë të tjerë në Shqipëri, në mënyrë që të arrijë një implementim të sukseshëm të strategjisë së saj dhe të optimizojë impaktin e tranzicionit.

Banka aktualisht është duke bashkëpunuar me donatorë multi dhe bilateralë për arritjen e një zgjidhjeje afatgjatë për krizën energjitike të vendit. Bashkëpunimi vazhdon në sektorin e transporteve me bashkë-financimin me Italinë të rehabilitimit të segmentit rrugor Elbasan-Librazhd. Përveç bashkë-financimit të projekteve të rehabilitimit fizik, Banka po punon aktivisht me donatorë të tjerë për koordinimin e dialogut mbi politikat për të nxitur procesin e reformave në sektorët e rëndësishëm të infrastrukturës. Ndërsa bashkëpunimi në sektorin publik po ecën mirë, duhet bërë më tepër për të çuar përpara implementimin e projekteve dhe përmirësimin e kapacitetit implementues, duke pasur parasysh dobësinë sistematike të vendit dhe eksperiencat e kaluara me projektet publike.

Banka ka zgjeruar bashkëpunimin me IFI të tjera në Shqipëri në sektorin privat duke bashkë-financuar me IFC-në projekte të mëdha të sektorit privat të korporatave dhe të atij financiar privat.

Banka gjithashtu merr pjesë aktivisht në dialogun mbi politikat në shkallë më të gjerë në Shqipëri. Ndërsa objektivat afatgjata të politikës së qeverisë Shqiptare përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Social-Ekonomik, të shprehur në Dokumentin mbi Strategjinë e Uljes së Varfërisë (PRSP), objektivat operative afatmesme përmbledhen në Programet Afat-Mesëm të Buxhetit (MTBP), të cilët mbulojnë periudha tre-vjeçare dhe rinovohen çdo vit. MTBP publikohet nga Ministria e Financave pas konsultimeve me IFI-t, donatorët e interesuar dhe organizatat ndërkombëtare, për t'u siguruar se ka burime të mjaftueshme për sipërmarrjet e propozuara. Ky buxhet përfshin edhe listën e projekteve prioritare dhe reformave si dhe partnerët që mbështesin implementimin e tyre. MTBP reflekton synimet afat-gjata të PRSP dhe koordinohet me dokumentet e strategjisë të botuar nga IFI-t, duke përfshirë Strategjinë për Asistencën ndaj Vëndit të Bankës Botërore/IDA, Programet Vjetore të BE-së, dhe Strategjinë për Vëndin të BERZH-it.

BERZH gjithashtu merr pjesë në takime të rregullta koordinimi për sektorë të rëndësishëm, me përfaqësues të qeverisë, BE-së, BB-së dhe donatorëve bilateralë. Debati mbi buxhetin dhe konsultimet e rregullta të udhëhequra nga FMN formojnë një platformë shtesë për dialog me qeverinë dhe IFI të tjera për të vendosur prioritetet për investime, për të koordinuar aktivitetin e donatorëve dhe për t'u konsultuar mbi projektet me garanci qeveritare. Tryeza e Rrumbullakët e Donatorëve, e cila zëvendësoi grupin "Miq të Shqipërisë", të formuar pas krizës në Kosovë, shërben si një platformë për ndarjen e informacionit mbi burime të disponueshme të donatorëve dhe planet tyre të veprimit. Përfundimisht, dialogu në nivele të larta politike, gjithashtu kryhet gjithashtu edhe në kuadrin e nismave të ndryshme të Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug Lindore.

Në përputhje me prioritetet e Bankës për dy vitet e ardhshëm, do të ndiqen objektivat e mëposhtme specifike për bashkëpunim me BE-në, IFI dhe donatorë të tjerë:

- Banka do të ruajë një bashkëpunim të afërt me Bankën Botërore, BE-në dhe institucione të tjera për të vazhduar dialogun mbi politikat me qeverinë për zgjidhjen e çështjeve në lidhje me përmirësimin e klimës për investimet. Banka, gjithashtu do të punojë me komunitetin e biznesit për të identifikuar pengesat ekzistuese për sektorin privat dhe veçanërisht për zhvillimin e SME-ve dhe për të përfituar informacion direkt mbi efektet e politikave dhe veprimtarisë qeveritare.
- Banka do të vazhdojë bashkëpunimin e afërt me IFC-në në sektorin bankar si dhe në projekte të mëdha të sektorit privat.
- Do të vazhdojë bashkëpunimi me BB-në, BEI-n dhe donatorë bilateralë për ristrukturimin dhe rehabilitimin e sektorit të energjitikës.
- Do të vazhdojë bashkëpunimi i afërt me BE-në, BEI-n, BB-në, Italinë, Gjermaninë, dhe donatorë të tjerë potencialë në sektorin e transportit (rrugët, portet dhe aeroportet).
- Do të bashkërendohet ngushtë me BB-në, BE-në, si dhe me ente të tjera të përfshira aktivisht në dialogun e politikave me autoritetet Shqiptare, përfshirja e investitorëve privatë në ndërtimin dhe administrimin e projekteve në fusha të rëndësishme të infrastrukturës si dhe asistencë për reformat sektoriale.

III. SHTOJCA

SHTOJCA 1: VLERËSIM POLITIK

Shqipëria u shpall republikë e pavarur në Nëntor 1912. Një e treta e shiptarëve etnike mbetën jashtë kufijve aktualë të caktuar në 1921. Nga 1939 deri në 1943, Shqipëria ishte nën pushtimin Italian dhe nga 1943 deri në 1944 nën atë Gjerman. Në vitin 1945, nën regjimin e ri Komunist, Shqipëria u kthye tek kufijtë e saj të para vitit 1939. Një kryengritje në Kosovë me qëllim bashkimin e saj me Shqipërinë dhe pjesën perëndimore të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë u shtyp nga autoritetet Jugosllave në Beograd. Nën udhëheqjen e Enver Hoxhës, Shqipëria u bë në fillim aleate e Jugosllavisë, me vonë e Rusisë dhe pastaj e Kinës, për të përfunduar në një izolim ndërkombëtar që zgjati deri në vdekjen e Hoxhës në 1985.

Zgjedhjet e para shumëpartiake në Shqipëri, të zhvilluara në Mars 1991 u fituan nga Partia Socialiste (ish-Komunistët që hoqën dorë nga Hoxha). Zgjedhjet e reja të mbajtura në Mars 1992 përfunduan me një fitore masive për Partinë Demokratike të udhëhequr nga Sali Berisha, i cili u zgjodh President i vendit. Mbështetja për Berishën u reduktua si rezultat i kombinimit të korrupsionit në rritje në administratën publike dhe stilit autoritar të Berishës. Partitë më të mëdha opozitare bojkotuan zgjedhjet parlamentare të Majit 1996 si protestë ndaj manipulimeve në zgjedhje dhe partia e Berishës fitoi përsëri. Megjithë kritikën e forta ndërkombëtare ky rezultat mbeti në fuqi. Berisha u rrëzua nga trazirat e përgjithshme të 1997 pas kolapsit të firmave piramidale. Rënia e tyre u ndoq nga një kryengritje masive popullore. Një forcë ndërkombëtare e udhëhequr nga Italia ndihmoi në rivendosjen e rendit. Një qeveri koalicioni e përkohëshme zhvilloi zgjedhjet në Qershor 1997 të cilat sollën në formimin e një koalicioni me në krye Partinë Socialiste të udhëhequr nga Fatos Nano. Nano u zëvendësua si kryeminister në 1998. Socialistët fituan zgjedhjet e 2001. Partia Demokratike fillimisht refuzoi të pranonte vendet e saj, por u kthye në Parlament në Janar 2002.


Berisha dhe Nano arritën një marrëveshje e cila i hapi rrugën zgjedhjes në postin e Presidentit në Qershor 2002 të Alfred Moisiut, ish-gjeneral i ushtrisë, në vend të Rexhep Meidanit. Nano u zgjodh përsëri Kryeministër në Korrik 2002. Pas mosmarrëveshjeve brenda Partisë Socialiste, disa ministra u larguan nga qeveria në Korrik 2003. Në Dhjetor 2003 Nano u rizgjodh lider i Partisë Socialiste. Në Janar 2004 pas një debati me partitë e vogla të koalicionit të majtë, ai kreu një riorganizim qeverisë. Megjithatë, Socialistët mbeten të ndarë. Partia Demokratike në opozitë pati rritje të mbështetjes në zgjedhjet lokale të Tetorit 2003, ku u evidentuan parregullsi të shumta nga vrojtuesit ndërkombëtarë. Opozita po ndihmohet edhe nga një pakënaqësi publike në rritje si shkak i dështimit të qeverisë në parandalimin e krimit të organizuar, veçanërisht trafikut të njerëzve. Zgjedhjet parlamentare janë caktuar në 2005.

SHTOJCA 2: TRANZICIONI LIGJOR

VLERËSIM KRAHASUES I LIGJIT TREGTAR TË SHQIPËRISË

I - Vlerësim në kohë

Mbulimi dhe Efektiviteti i Ligjit Tregtar Shqiptar³



Burimi: OGC Legal Indicator Surveys; 1997 - 2002

*Shen: Treguesit në boshtin y lëvizin nga 1 (pak progres) në 5 (progres i madh)

Sipas Pyetësorit Vjetor mbi Treguesit Ligjorë të BERZH-it, nisur në vitin 1997, ligjet tregtare të Shqipërisë kanë ende nevojë për ndryshime të konsiderueshme për të arritur standartet e pranuar në përgjithësi në arenën ndërkombëtare. Megjithatë, profesionistët ligjorë lokalë të pyetur raportojnë se trendi që nga viti 2000 tregon një rritje të efektivitetit të ligjeve tregtare dhe në përgjithësi një zvogëlim të distancës midis mbulimit ligjor dhe efektivitetit të këtyre ligjeve.

II - Situata në vendet e tjera në tranzicion

Cilësia e ligjeve tregtare të Shqipërisë është në përgjithësi e afërt me atë të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Sipas Pyetësorit Vjetor mbi Treguesit Ligjorë të

³ Nga viti 1997 në 2002, BERZH ka zhvilluar një anketim për Treguesit Ligjorë cdo vit për të matur progresin e reformës në Evropën Qendrore dhe Lindore, Shtetet e Balltikut dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavaruara, ashtu siç shihet nga juristët dhe akademikët lokalë. Rezultatet e kësaj ankete bazohen në përgjigjet në pyetësorin e dërguar juristëve që praktikojnë në secilin vend. Anketa paraqet perceptimin e tyre për sistemin ligjor të vendit dhe, në veçanti masën në të cilën disa ligje kyçe financiare dhe tregëtare kanë arritur të përmbushin standarde të pranueshme ndërkombëtare (mbulimi) dhe në çfarë mase këta ligje po aplikohen dhe zbatohen (efektiviteti). Anketa bazohet vetëm në perceptimin e juristëve lokalë mbi legjislativonin e vendit të tyre dhe nuk paraqet opinionin e BERZH-it mbi këto sisteme ligjorë. Si shtesë, duhet theksuar se secili jurist i pyetur kërkohet të përgjigjet në anketë vetëm për vendin e tij dhe jo mbi baza krahasuese.

BERZH-it në vitin 2002, i cili mat perceptimin e juristëve vendorë, ligjet tregtare në Shqipëri cilësohen si “minimalisht të përshtatshëm” për të mbështetur investimet dhe aktivitetet e tjera tregtare në vend.

Sipas Pyetësorit të vitit 2002, midis shkaqeve të përceptuara për performancën e dobët të legjislacionit Shqiptar ishte pasiguria në aplikimin e ligjit (të atëhershëm) mbi falimentimin dhe transaksioneve e siguruara, si dhe mangësitë në legjislacionin bankar dhe të tregjeve të kapitalit.

VLERËSIMI I SEKTORIT LIGJOR

Falimentimi

Legjislacioni kryesor që rregullon procedurat e falimentimit në Shqipëri është Ligji mbi Procedurat e Falimentimit i vitit 2002 (“Ligji mbi Falimentimin”). Ky ligj zëvendëson ligjin e mëparshëm të vitit 1995.

Një pyetësor për vlerësimin e ligjit të falimentimit kryer kohët e fundit nga BERZH-i (“Pyetësori i Vlerësimit”)⁴ përfshiu edhe analizën e sistemit ligjor Shqiptar, duke vlerësuar Ligjin mbi Falimentimin si të pjekur dhe të plotë. Pyetësori i Vlerësimit gjithashtu vuri në dukje se përcaktimet e ligjit në lidhje me fillimin, dëgjimin dhe vendimin për nisjen e aplikimit, përfshirjen e kreditorëve dhe shmangien e transaksioneve para falimentimit shihen si veçanërisht të qartë dhe ndihmues.

Duke njohur përpjekjet e Shqipërisë për të zhvilluar legjislacionin mbi falimentimin, Pyetësori i Vlerësimit gjithashtu nxorri në pah disa fusha që kishin mangësi përsa i përket përmbushjes së standardeve ndërkombëtare. Midis mangësive të vëna re ishin të mëposhtmet:

- i) Mungesa e kualifikimit të mjaftueshëm për personat të cilët mund të vendosen si administratorë të falimentimit;
- ii) Mungesa e detyrimeve dhe përgjegjësive ndaj debitorëve dhe palëve të treta të lidhura për të dhënë informacion;
- iii) Përrjashtimi i rasteve të falimentimit kur asetet janë të pamjaftueshëm për të mbuluar kostot e procesit të falimentimit;
- iv) Mungesa e përcaktimeve të përshtatshme që mundësojnë një kreditor të përcaktojë pamundësinë e një debitori për të paguar një borxh të maturuar.

Gjithashtu, vlerësimi pasqyroi mungesën e qartësisë mbi kontrollin dhe menaxhimin e një debitori i cili kërkon të propozojë një plan ri-organizimi, ose mbi përcaktimet në lidhje me financimin e një debitori gjatë fazave të para të një ri-organizimi të mundshëm.

Tregjet e kapitalit

Legjislacioni kryesor që qeveris tregun e letrave me vlerë është Ligji mbi Letrat me Vlerë i vitit 1996, i amenduar në Shkurt 2001. Rregullatori kryesor i tregut të letrave me vlerë është Komisioni Shqiptar i Letrave me Vlerë (“KSHLV”), i krijuar sipas

⁴ Shih: <http://www.ebrd.com/country/sector/law/insolve/assess/albania.pdf>

Ligjit mbi Letrat me Vlerë. KSHLV përbëhet nga shtatë komisionerë, të caktuar nga Kuvendi Popullor për një afat pesë-vjeçar. Dy nga komisionerët propozohen nga Presidenti i Shqipërisë, dy nga Kuvendi Popullor, një nga Këshilli i Ministrave, një nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe një nga Banka e Shqipërisë. KSHLV ka autoritetin të licensojë çdo person ose person juridik që dëshiron të organizojë një treg letrash me vlerë ose të merret me investime në letra me vlerë. Si shtesë të Ligjit mbi Letrat me Vlerë, sipas KSHLV-së, Qeveria po shqyrton aktualisht një projektligj “Mbi Investimet Kolektive në Fondet e Letrave me Vlerë”, qëllimi kryesor i të cilit është të krijojë një kuadër më të plotë rregullator për të qeverisur investimet kolektive dhe të sigurojë një mbrojtje më të madhe të investorëve nëpërmjet ndalimit të nxitjes në publik të investimeve të paligjshme në letra me vlerë.

Bursa e Tiranës (“BT”) u themelua në vitin 1996, por ka pasur një aktivitet tregëtues të kufizuar (kryesisht bono të thesarit dhe letra me vlerë për privatizim). Një rregullore e përhapur në Prill 1999 përcaktoi funksionet dhe aktivitetin e bordit mbikqyrës të BT-së, dhe përcaktoi se të gjitha aktivitetet e BT-së drejtohen nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë, i cili drejtohet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë. Amendamentet e vitit 2001 për Ligjin e Letrave me Vlerë e ndryshuan këtë strukturë dhe caktuan një periudhë gjashtë mujore, nën drejtimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Privatizimit, për transformimin e BT-së në një shoqëri tregtare.

Tregu i sigurimeve qeveriset nga Ligji mbi Sigurimet dhe Aktivitetet e Ri-sigurimit i vitit 1996, i cili liberalizoi tregun e sigurimeve duke lejuar kompani vendase dhe të huaja të veprojnë në vend. Kompanitë e huaja mund të investojnë direkt, duke blerë deri 40 përqind të drejtimit të kompanive lokale të sigurimeve. Licensat për kompanitë për sigurim dhe ri-sigurim jepen nga Komisioni Mbikqyrës i Sigurimeve, i cili ka autoritet të përgjithshëm supervizues mbi sektorin e sigurimeve.

Ligji mbi kompanitë dhe qeverisja e korporatave

Ligji mbi Kompanitë Tregtare (“Ligji mbi Kompanitë”) u qarkullua në vitin 1992 dhe u amendua për herë të fundit në vitin 1995. Sipas Ligjit mbi Kompanitë, organizatat mund të krijohen në këto forma: ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, kompani me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri tregtare dhe ortakëri e kufizuar me aksione.

Kapitali minimal i kërkuar për të formuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është 100,000 Lekë; kapitali minimal është 10,000,000 Lekë për shoqëritë tregtare që ofrojnë aksione për publikun dhe 2,000,000 Lekë për shoqëritë tregtare që nuk ofrojnë aksione për publikun. Një shoqëri tregtare është e detyruar të këtë dy ose me shumë aksionerë në çastin e krijimit. Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve është hallka më e lartë vendim-marrëse. Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve cakton një bord mbikqyrës të përbërë nga 3 deri në 21 anëtarë për të mbikqyruar veprimtaritë e përditëshme të kompanisë. Nuk është kusht që anëtarët e bordit të jenë qytetarë Shqiptarë. Në mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve lejohet edhe votimi me delegim (prokurë). Ligji mbi Kompanitë u jep gjithashtu të drejtë aksionerëve të ndërmarrin veprime për shfuqizimin e vendimeve të aksionerëve nëse evidentohen shkelje të rregullave mbi mbajtjen e mbledhjes e përgjithshme të aksionerëve. Gjithashtu në Ligj përcaktohen edhe kërkesa për transparencë dhe dhënie

informacioni për të sqaruar rastet, kur transaksionet e kompanisë përbëjnë konflikt interesi.

Sipas rezultateve të vitit 2003 të Projektit të BERZH-it për Vlerësimin e Sektorit të Qeverisjes së Korporatave⁵, Shqipëria është një vend ligjet e së cilës mbi qeverisjen e korporatave (p.sh. “ligji mbi librat” krahasuar me zbatimin e këtij ligji) u radhitën në kategorinë me “përmbushje mesatare” në krahasim me Parimet e Qeverisjes së Korporatave të OECD-së. Prioritetet e përgjithëshme të reformës në këtë kategori janë përmirësimi i implementimit efektiv dhe zbatimi i legjislacionit aktual, duke vazhduar përpjekjet për përmirësimin e ligjeve ekzistuese.

Konçesionet

Konçesionet dhe Partneritetet Publiko-Private rregullohen nga Ligji mbi Konçesionet dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimet Publike dhe Infrastruktura të vitit 1995, amenduar në vitin 1996 (“Ligji mbi Konçesionet”). Sipas Ligjit mbi Konçesionet, një kompani ose individ, vendas ose i huaj ose një grup asyresh, mund të jetë marrësi i konçesionit. Përveç Ligjit mbi Konçesionet, çështjet e konçesioneve qeverisen edhe nga disa ligje të ndryshme sektorësh dhe rregulloresh.

Ligji mbi Konçesionet jep një listë të plotë të sektorëve që mund të zhvillohen në bazë konçesionesh. Sipas Ligjit mbi Konçesionet, lizingu shihet si një “mënyrë” konçesioni. Rregullime të tjera për pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet e infrastrukturës publike përfshijnë: kontrata menaxhimi, kontrata shërbimi dhe kontrata të llojit BOT/BOO/BOOT.

Ligji mbi Konçesionet ka mungesa në mbulim, sidomos përsa i përket pjesës së procedurave. Specifikisht, ligji nuk jep rregulla të detajuara në lidhje tenderimin ose me marrëveshjet konçesionare. Rregullat që qeverisin procesin e përzgjedhjes janë aktualisht të paqarta dhe të paplotë duke mos përcaktuar kërkesat për para-seleksionimin ose përzgjedhjen e parë (short-listing) të ofertave, publikimin e kritereve, vlerësimin e propozimeve ose publikimin e njoftimit për fitimin e konçesionit. Megjithë këto mangësi, që nga hyrja në fuqi e Ligjit mbi Konçesionet, është dhënë një numër i konsiderueshëm konçesionesh, veçanërisht në nivel bashkiak, duke përfshirë edhe konçesione për të huaj.

Ligji mbi Konçesionet e lë kryesisht në dorë të palëve të negociojnë dhe vendosin kushtet për marrëveshjen e konçesionit. Ligji nuk cakton specifikisht ndonjë kompensim në rast të prishjes së kontratës nga ana e autoriteteve kontraktuese, dhe nuk ka një nen mbi stabilitetin për t’u mbrojtur nga përkeqësimi i ligjeve pasi ka filluar marrëveshja konçesionale. Ligji mbi Konçesionet jep mundësinë për të kaluar në arbitrazh ose për t’u paraqitur para sistemit gjyqësor shqiptar për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, megjithëse nuk është e qarta nëse është i mundur arbitrazhi i huaj.

⁵ Shih: <http://www.ebrd.com/country/sector/law/corpgov/assess/albania.pdf>

Transaksionet e siguruara

Pengu mbi asetet e luajtëshme qeveriset kryesisht nga Ligji mbi Barrët Siguruese, i miratuar në Tetor 1999 dhe implementuar plotësisht që nga viti 2001. Kodi Civil (Art. 530-558, 601-607) është gjithashtu i aplikueshëm, veçanërisht Neni 605 mbi prioritetet i ndryshuar së fundmi. Ligji mbi Barrët Siguruese mbulon “të gjithë transaksionet, pa dallim forme apo klasifikimi, që krijojnë një barrë siguruese, përmes transferimit të pronësisë, pasjes në pronësi si në rastin e pengjeve ose në çdo formë tjetër” mbi çdo gjë të luajtëshme, prona apo të drejta të paprekshme, si dhe mbi “mallra me numra serie” si makineri bujqësore, aeroplanë, motorë aeroplanësh, automobilë, barka, makina ndërtimi, motoçikleta, mjete motorike, trailera dhe tramvaje. Regjistri Qendror i Barrëve Siguruese filloi nga puna në Shkurt 2001 dhe sistemi po nxitet me mbështetjen e Bankës Botërore, SEED, dhe IFC-së. Numri i regjistrimeve (5000 në vit në 2002) tregon që ka interes të përdoruesëve për institucionin.

Marrja e barrës siguruese mbi asetet e paluajtëshme qeveriset nga Kodi Civil (Nene. 560-607), dhe barrët mbi pronën e paluajtëshme kërkohet të regjistrohen në regjistrin lokal për pronat e paluajtëshme.

Kuadri ligjor aktual paraqet një numër paqartësish ose mangësish, të cilat mund të krijojnë probleme kur palët përgatisin transaksionet e tyre. Kjo mund të ndodhë veçanërisht në rastet kur barra krijohet mbi inventarin, i cili përfshin “mallra me numër serie” – sepse këto mallra duhet të regjistrohen individualisht sipas numrit serial sapo ato të nxirren nga inventari. Po kështu çështja e prioriteteve të barrëve trajtohet në një mënyrë disi komplekse. Barrët siguruese të kompletuara kanë prioritet më të lartë se ato të pakompletuara, megjithëse këto të dytat mund të jenë të vlefshme ndaj një pale të tretë në rrethana të caktuara. Gjithashtu, detyrimet ndaj buxhetit të shtetit dhe detyrimet e sigurimeve shoqërore për sigurimin e detyruar mund të kenë në disa raste prioritet mbi mbajtësit e pengjeve.

Përcaktimet mbi ekzekutimin e barrëve kanë si qëllim krijimin e një sistemi të shpejtë të orientuar drejt kreditorëve, duke i dhënë mbajtësit të pengut të drejtën automatike të kërkojë sipas urdhërit të gjykatës kompetente, që zyra e përmbarimit të marrë pronësi asetet në rastin kur dhënësi i pengut shkel kontratën. Për të realizuar kolateralin, asetet e lëna peng mund të shiten publikisht ose privatisht (duke përfshirë ankande publike ose tendera të mbyllur), në tërësi si njësi tregtare ose në pjesë, por gjithmonë në një mënyrë të arsyeshme sipas koncepteve të tregut, duke i dhënë kështu fleksibilitet të madh mbajtësit të pengut. Në Pyetësorin e BERZH-it mbi Treguesit Ligjorë të vitit 2003, Shqipëria u rendit pak mbi mesataren përsa i përket eficiencës në procesin e zbatimit të detyruar të barrëve. Problemet më të mëdha të identifikuar lidhen me kontekstin institucional, ku gjykatat u raportuan si të ngadalta dhe pa eksperiencë në trajtimin e rasteve të zbatimit të detyruar, si dhe me një potencial të lartë për korrupsion.

Telekomunikacionet

Spektori i telekomunikacioneve rregullohet aktualisht nga Enti i Rregullimit të Telekomunikacioneve (“ERT”) dhe qeveriset nga Ligji mbi Telekomunikacionet i vitit 1995 dhe 2000. ERT raporton dhe zbaton politikat e caktuara nga Ministria e Transportit

dhe Komunikacioneve (“Ministria”). ERT u krijua në vitin 1998 si një ent i pavarur vetë-financues, i projektuar të nxisë transparencën dhe investimet në sektor. Kuadri për zhvillimet e ardhshme në sektor, duke përfshirë modernizimin e infrastrukturës së telekomunikacioneve dhe shtrirjen e aksesit në shërbime publike në të gjithë vendin, përcaktohet nga një dokument qeveritar mbi politikën e vitit 1999. Parimet bazë mbi të cilat qeveria kërkon të zhvillojë sektorin përfshijnë rritjen mundësive për shërbime telefonike me një çmim të pranueshëm, konkurrencë dhe zgjedhje për përdoruesit dhe përmirësimin e mbrojtjes për konsumatorët. Ligji mbi Telekomunikacionet e vitit 2000, i cili u hartua me asistencën e BERZH-it, përcakton një kuadër modern për implementimin e politikave shtetërore dhe parashtron kërkesat thelbësore për zhvillim dhe standardet minimale brenda sektorit, duke përfshirë këtu përcaktimin e frekuencave radio, pagesat për licensat, dhe siguron një mjedis për oferta shërbimi konkurruese.

Ndërsa zhvillimet e politikave dhe legjislacionit e kanë afruar Shqipërinë me standardet moderne, implementimi i tyre është zhgënjyes dhe lë për të dëshiruar. Më në veçanti, ndërsa privatizimi i operatorit celular në pronësi shtetërore, AMC, dhe dhënia e licensës së dytë GSM për Vodafone-in kanë krijuar një treg konkurrues me zhvillim të shpejtë të telefonisë celulare, dështimi nga ana e qeverisë në implementimin dhe përfundimin e fushave kyçe të mjedisit rregullator pengon zhvillimin e mëtejshëm në këtë fushë dhe në tërë sektorin në përgjithësi.

Megjithëse monopoli i Albtelekom u hoq në fillim të vitit 2003, dështimi në implementimin e një kuadri rregullator modern ka sjellë në një situatë ku Albtelekom ka mbetur operatori i vetëm i shërbimeve ndërkombëtare dhe për distanca të gjata të telekomunikacionit. Në këtë aspekt, vendimi i qeverisë për të kërkuar një anulim të përkohshëm të angazhimit të saj për liberalizimin e telekomunikacioneve, i cili u kërkua si pjesë e antarësimit të Shqipërisë në OBT, nuk sjell progres.

Ndërsa formalisht ekziston një autoritet rregullator i pavarur në Shqipëri, në formën e ERT-së, kapaciteti i tij për të zbatuar dhe administruar kuadrin modern parashikuar nga politika dhe ligji, është tepër i kufizuar nga mungesa e ekspertizës dhe burimeve të përshtatëshme dhe angazhimit të pamjaftueshëm nga ana e qeverisë për të trajtuar këto çështje dhe për të mbështetur implementimin e reformave të nevojshme (p.sh. interkoneksionet, reforma në tarifa dhe aksesit universal). Një implementim i plotë i një regjimi modern për telekomunikacionet do të sillte një kontribut të ndjeshëm në përmirësimin e klimës për shërbimet celulare dhe fikse. Qeveria duhet që tashmë të sigurojë mbështetje të menjëhershme dhe burime të përshtatëshme për ERT-në në përpjekjet e tyre për implementimin e një kuadri modern rregullator.

SHTOJCA 3: TREGUES TË ZGJEDHUR EKONOMIKË

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
										<i>Est.</i>	<i>Proj.</i>
Prodhimi dhe Shpenzimet											
	<i>(Ndryshimi i përqindjes në terma reale)</i>										
PBB	8.3	13.3	9.1	-7.0	12.7	8.9	7.7	6.8	4.7	6.0	6.0
Prodhimi industrial bruto	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1	6.4	5.0	6.5	2.0	na	na
Prodhimi agrar bruto	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0	3.7	4.5	1.4	2.1	na	na
Punësimi											
	<i>(Ndryshimi i përqindjes)</i>										
Fuqia punëtore (mesatare vjetore)	1.3	1.8	1.8	-23.6	1.5	-1.1	-1.8	-2.7	-12.3	-0.2	na
Punësimi (mesatare vjetore)	9.7	5.7	-2.5	-0.8	-2.0	-0.4	-1.3	-0.2	-13.5	0.8	na
	<i>(Në përqindje të fuqisë punëtore)</i>										
Papunësia (mesatare vjetore) 1/	16.1	13.9	9.3	14.9	17.8	18.0	16.8	14.6	15.8	15.0	na
Çmimet dhe Rrogat											
	<i>(Ndryshimi i përqindjes)</i>										
Çmimet e konsumatoreve (mesatare vjetore)	22.6	7.8	12.7	33.2	20.6	0.4	0.1	3.1	5.4	3.3	3.0
Çmimet e Konsumatoreve (fundviti)	15.8	6.0	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2	3.5	1.7	3.6	3.0
Te ardhurat mesatare mujore bruto (mesatare vjetore)	46.9	25.6	20.0	0.0	26.1	-0.3	14.3	13.0	28.1	na	na
Sektori Qeveritar 2/											
	<i>(Në përqindje të PBB-së)</i>										
Bilanci i përgjithshëm qeveritar	-12.6	-10.1	-12.1	-12.9	-9.7	-9.1	-7.9	-7.6	-6.3	-5.6	-6.0
Shpenzimet e përgjithshme qeveritare	36.4	33.4	30.3	30.2	33.2	33.9	30.7	30.4	29.0	28.5	29.34
Borxhi i përgjithshëm qeveritar	na	57.5	55.2	75.6	70.9	67.5	71.6	67.7	63.2	61.3	59.7
Sektori Monetar											
	<i>(Ndryshimi i Përqindjes)</i>										
M3 (fundviti)	40.6	51.8	43.8	28.5	20.6	22.3	12.1	20.1	3.5	9.0	10.6
Kredia e brendshme (fundviti)	17.8	-10.0	47.2	42.2	20.2	9.8	39.0	4.1	6.7	11.0	12.1
	<i>(Në përqindje të PBB-së)</i>										
M3 (fundviti)	38.4	46.8	55.0	59.6	58.1	61.8	61.8	64.4	61.5	59.8	59.9
Përqindjet e Interesit dhe Shkqmbimit											
	<i>(Në përqindje vjetore për fundviti)</i>										
Interesi i marrëveshjes së riblerjes Kthimi i bonove të thesarit (maturim 3-mujor)	25.0	20.5	24.0	32.0	22.9	17.8	10.8	7.0	8.5	6.5	na
Interesi i depozitave (një vit) 3/	na	13.8	17.8	32.6	27.5	17.5	10.8	8.0	11.2	7.4	na
Interesi i kredisë (një vit) 4/	16.5	13.7	19.1	28.5	16.5	9.1	7.7	7.7	9.3	7.6	na
	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0	25.8	23.7	11.9	16.0	11.1	na
	<i>(Leke për USD)</i>										
Kursi i këmbimit (fundviti)	95.0	94.5	103.7	149.8	141.4	135.2	142.6	137.0	135.0	108.7	na
Kursi i këmbimit (mesatare vjetore)	94.7	92.8	104.5	148.9	150.6	137.5	143.7	143.8	140.2	123.1	na
Sektori i Jashtëm											
	<i>(Në milionë USD)</i>										
Llogaria Korente	-279	-177	-245	-276	-186	-265	-274	-263	-435	-509	-555
Bilanci tregtar	-460	-475	-692	-518	-621	-846	-824	-1,028	-1,155	-1,371	-1,469
Eksporti i mallrave	141	205	229	167	205	275	255	305	330	426	490
Importi i mallrave	601	680	921	685	826	1,121	1,076	1,333	1,485	1,797	1,959
Investim direkt i huaj (FDI) neto	65	89	97	42	45	51	143	204	135	192	217
Rezervat bruto (fundviti), përjashtuar ari	204	240	275	306	384	485	620	754	860	974	1,019
Borxhi i jashtëm	1,074	787	845	877	1,007	1,108	1,173	1,198	1,178	1,405	1,540
	<i>(Në muaj importi të mallrave dhe shërbimeve)</i>										
Rezervat bruto (fundviti), përjashtuar ari	2.9	2.7	4.0	3.8	3.7	3.8	4.2	4.3	4.3	4.4	4.4
	<i>(Në përqindje eksporti të mallrave dhe shërbimeve)</i>										
Ripagimi i borxhit	19.7	2.5	6.0	6.1	6.2	3.8	4.0	4.2	6.4	5.1	6.2
Të dhëna të tjera											
	<i>(Monedhat si tregohen në përshkrim)</i>										
Popullsia (mesatare vjetore, miliona)	3.2	3.2	3.3	3.4	3.4	3.4	3.4	3.4	3.4	3.4	3.4
PBB (në milionë lek)	184,393	229,793	280,998	333,071	425,356	488,611	551,282	611,622	677,272	744,600	821,600
PBB për frymë (në USD)	608	762	819	667	837	1,045	1,119	1,241	1,409	1,765	2,205
Pjesa e industrisë në PBB (në përqindje)	12.5	11.7	12.2	12.4	11.9	11.9	11.5	11.7	11.4	na	na
Pjesa e bujqësisë në PBB (në përqindje)	54.6	54.6	51.5	56.0	54.4	52.6	51.0	49.0	48.1	na	na
Llogaria korente/PBB (në përqindje)	-14.3	-7.1	-9.1	-12.3	-6.6	-7.5	-7.1	-6.2	-9.0	-8.4	-7.3
Borxhi i Jashtëm – Rezerva, në milionë USD	870	547	570	571	623	624	553	444	318	431	521
Borxhi i Jashtëm/PBB (në përqindje)	55.1	31.8	31.4	39.2	35.7	31.2	30.6	28.2	24.4	23.2	20.4
Borxhi i Jashtëm/eksport mallrash (në përqindje)	487.3	259.1	235.9	380.0	345.4	203.6	166.8	142.7	128.7	129.5	129.7

1/ Shifrat nuk tregojnë punëtorët ne emigrim të cilët llogariten në rreth 18 përqind të fuqisë punëtore në1995.

2/ Sektori i përqitshëm qeveritar përfshin shtetin, bashkitë dhe fondet ekstra-buxhetore. Bilanci i buxhetit tregohet në baza angazhimesh.

3/ Deri në 1995 shifrat i referohen dyshemesë së vendosur nga Banka Qendrore. Nga 1995 e mbrapa i referohen interesit mestar për një depozitë 1-vjeçare në bankat tregtare.

4/ Deri në 1995 të dhënat i referohen përqindjes udhërrëfyese të shpallur nga Banka Qendrore. Nga 1995 e mbrapa të dhënat i referohen interesit mestar caktuar nga bankat tregtare për një kredi 1-vjeçare.

SHTOJCA 4: PROJEKTE TË APROVUARA TË BANKËS
Statusi i portofolit në Shqipëri
(në 31 Dhjetor 2003, Euro milionë)

Emri i operacionit	Kredi	Investim në kapital	Garanci tregtare	Total nga BERZH	Pa lëvruar	Asetet operative	Portofoli neto
Institucionet Financiare							
Banka Italo-Shqiptare		2.6		2.6	0	2.6	2.6
Fond për investime në kapital <i>(Albania Reconstruction Equity Fund)</i>		2.8		2.8	0	1.7	1.9
Banka ProCredit		1.1		1.1	0	1.1	1.1
Linjë Kredie për SME-të	1.1			1.1	0	0.4	0.4
Banka Kombëtare Tregtare		2.3		2.3	0.0	2.3	2.3
INSIG		4.7		4.7	4.7	0	4.7
TFP: Banka Amerikane e Shqipërisë			2.0	2.0		0	0
TFP: Banka Italo-Shqiptare			1.6	1.6		0	0
Infrastruktura							
<i>Energjitika</i>							
Rindërtimi i sektorit energjitik	30.0			30.0	8.4	15.6	24.0
Rehabilitimi i shpërndarjes së energjisë	24.0			24.0	23.6	0.4	24.0
<i>Transporti</i>							
Rehabilitimi i rrugës Elbasan-Librazhd	17.0			17.0	13.5	3.5	17.0
Industria dhe Tregëtia							
<i>Telekomunikacioni</i>							
Telekomi Shqiptar	7.8			7.8	0	2.5	2.5
Vodafone Albania	42.5			42.5	42.5	0	42.5
<i>Agrobiznes</i>							
Coca-Cola Tirana		3.2		3.2	0	0	0
<i>Prona, Turizem</i>							
Tirana Hotel	10.1	0.8		10.9	0.0	5.1	5.1
Hotel Rogner	16.9	2.0		18.9	0.0	3.8	3.8
Totali për vendin	149.4	19.5	3.6	172.5	92.9	39.0	131.9

SHTOJCA 5: PROGRAME TË BERZH-IT PËR BASHKËPUNIM TEKNIK

(Përmbledhje në 31 Dhjetor 2003)

Angazhime sipas Sektorit	€	€
	Angazhuar	Disbursuar
Bujqësi, Pyje	154,013	154,013
Komunitet / Shërbime Sociale	499,002	278,934
Energji	4,270,660	3,055,271
Financë, Biznes	5,538,966	4,998,372
Industri Nxjerrëse	243,090	243,090
Manifaktura	59,123	59,123
Telekomunikacione	1,970,039	1,970,039
Turizëm	222,763	222,763
Transport / Ndërtime	2,762,836	1,002,585
TOTAL GJITHSEJ (72 angazhime)	15,720,492	11,984,190

(Lista e Detajuar e Projekteve në 31 Dhjetor 2003)

Nr	Year	Emri i angazhimit	Euro Angazhuar	Euro Disbursuar	Faza e Angazh.	Sektori
1	1993	Studim fizibiteti për Industrinë Pyjore	154,013	154,013	Mbyllur	Agrikulturë, Pyje, Peshkim
2	1993	Këshillim për zhvillimin e turizmit	63,430	63,430	Mbyllur	Tregti, Turizëm
3	1992	Zhvillimi i turizmit – studime mbi turizmin	103,422	103,422	Mbyllur	Tregti, Turizëm
4	1992	Zhvillimi i turizmit – ndryshimet ligjore dhe institucionale	55,911	55,911	Mbyllur	Tregti, Turizëm
5	2002	Keshilltar privatizimi për Hotel Tirana	39,686	33,733	Në Disbursim	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
6	1995	Shërbime konsulence mbi bashkë-financimet	22,827	22,827	Mbyllur	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
7	1996	Asistencë për task-forcën e parkut industrial Durrës	62,269	62,269	Mbyllur	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
8	1999	Takimi Vjetor 1999 – Akomodimi për delegacionin Shqiptar	1,306	1,306	Mbyllur	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
9	1997	Parku industrial Durrës – asistencë teknike për task-forcën	46,149	46,149	Mbyllur	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
10	1992	Analiza Mjedisore	49,187	49,187	Mbyllur	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
11	1993	Workshop parlamentar	26,912	26,912	Mbyllur	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
12	2001	Hotel Tirana	250,665	36,550	Angazhuar	Komunitet/Sherbimet Shoqërore
13	2001	CEI Rehabilitimi i Rrugëve të Korridorit VIII në Shqipëri	1,700,000	0	Angazhuar	Ndertim
14	1993	Vendosja e parqeve industriale – studimi i para-fizibilitetit	91,805	91,805	Mbyllur	Ndertim
15	1998	Projekti i Rehabilitimit të Rrugëve Shqipëri	679,410	679,410	Mbyllur	Ndertim
16	1994	Vendosja e parqeve industriale – studimi i para-fizibilitetit	30,000	30,000	Mbyllur	Ndertim
17	2000	Projekti i rehabilitimit të rrugës Elbasan-Librazhd – Konsulent monitorimi	105,000	44,749	Në Disbursim	Ndertim
18	1994	Planifikimi i investimeve në sektorin energjitik - Lumi Drin (rehabilitimi i hidrocentraleve të vegjël)	47,267	47,267	Mbyllur	Energjitikë
19	1994	Financimi i projektit ambientalist të Danimarkës	130,593	130,593	Mbyllur	Energjitikë
20	1993	Studimi i rehabilitimit dhe modernizimit të Hidrocentraleve	161,437	161,437	Mbyllur	Energjitikë
21	1995	Studimi i fizibilitetit të transmetimit të energjisë	204,267	204,267	Mbyllur	Energjitikë
22	2000	Asistencë për Manaxhimin e KESH	1,946,899	1,896,862	Në Disbursim	Energjitikë
23	2003	Asistencë për Manaxhimin e KESH	1,165,352	0	Angazhuar	Energjitikë
24	1994	Rehabilitimi i Kaskadës së Drinit – projekti inxhinierik dhe i menaxhimit	363,694	363,694	Mbyllur	Energjitikë
25	1992	Naftë – vlerësimi dhe negociimi i ofertave të huaja	130,223	130,223	Mbyllur	Energjitikë
26	1993	Studim mbi matjen e eficiencës së turbinave	79,741	79,741	Mbyllur	Energjitikë
27	1992	Rehabilitimi i sektorit të energjitikës	16,964	16,964	Mbyllur	Energjitikë
28	1992	Fabrikë tullash	24,223	24,223	Mbyllur	Energjitikë
29	1992	Privatizimi i Albkrom – konsulencë mbi minierat	90,285	90,285	Mbyllur	Industritë Nxjerrëse
30	1992	Asistencë legale – naftë në tokë	61,839	61,839	Mbyllur	Industritë Nxjerrëse
31	1992	Këshilltar për industrinë e kromit	90,966	90,966	Mbyllur	Industritë Nxjerrëse
32	1998	AREF	2,381,141	2,018,439	Në Disbursim	Financë, Biznes
33	2003	AREF	152,393	0	Angazhuar	Financë, Biznes
34	2000	Hua të CEI për Sipërmarrësit e Vegjël në Shqipëri	268,586	268,586	Mbyllur	Financë, Biznes
35	1993	Qendra e Trainimit Bankar	127,923	127,923	Mbyllur	Financë, Biznes
36	1993	Qendra e Trainimit Bankar	60,320	60,320	Mbyllur	Financë, Biznes
37	1993	Qendra e Trainimit Bankar	31,715	31,715	Mbyllur	Financë, Biznes
38	1993	Këshilltar Kontabiliteti për bankat tregëtare	131,231	131,231	Mbyllur	Financë, Biznes
39	1993	Themelimi i qendrës së promovimit të biznesit	39,602	39,602	Mbyllur	Financë, Biznes
40	1995	Bankë për kreditimin e pasurive të paluajtshme – konsulencë legale	25,654	25,654	Mbyllur	Financë, Biznes
41	1995	Bankë për kreditimin e pasurive të paluajtshme – analizë tregu	25,654	25,654	Mbyllur	Financë, Biznes
42	1992	Bankat tregëtare – vendosja e sistemeve të kontabilitetit	193,200	193,200	Mbyllur	Financë, Biznes
43	1992	Zhvillimi i sistemit bankar	27,144	27,144	Mbyllur	Financë, Biznes
44	1993	Trainim për bankat tregëtare	147,692	147,692	Mbyllur	Financë, Biznes

45	1991	Teknika ristrukturimi në banka/trainimet	11,364	11,364	Mbyllur	Financë, Biznes
46	1992	Kontabiliteti në bankat tregëtare	27,270	27,270	Mbyllur	Financë, Biznes
47	1992	Bankat tregëtare – pajisjet kompjuterike për sistemet e kontabilitetit (pjesa e lidhur)	149,466	149,466	Mbyllur	Financë, Biznes
48	1992	Negociata me kreditorët e jashtëm	77,364	77,364	Mbyllur	Financë, Biznes
49	2003	INSIG – Këshillat mbi Sigurimet për Menaxherin e Përgjithshëm.	42,340	16,842	Në Disbursim	Financë, Biznes
50	2000	Banka FEFAD– Zgjerim Dege	1,041,163	1,041,163	Mbyllur	Financë, Biznes
51	2001	Banka FEFAD – Mbështetje për zgjerimin e degës	577,743	577,743	Mbyllur	Financë, Biznes
52	2001	Programi TAM – Ajka	11,226	11,226	Mbyllur	Manufaktura
53	1996	TAM – Instituti i Sigurimeve	29,990	29,990	Mbyllur	Manufaktura
54	1996	TAM – kontrtë për shërbimet e konsulencës - Alb-Baker	17,907	17,907	Mbyllur	Manufaktura
55	1992	Programi i Zhvillimit Institucional – vlerësimi i kërkesave të zhvillimit të menaxhimit	48,000	48,000	Mbyllur	Telekomunikacione
56	1993	Programi i Zhvillimit Institucional – kontabilitet dhe financë	258,901	258,901	Mbyllur	Telekomunikacione
57	1993	Programi i Zhvillimit Institucional – operacionet dhe mirëmbajtja	390,660	390,660	Mbyllur	Telekomunikacione
58	1993	Programi i Zhvillimit Institucional – Menaxhimi i Projekteve dhe Implementimi	0	0	Mbyllur	Telekomunikacione
59	1993	Programi i Zhvillimit Institucional – studim mbi diagnozën e strategjisë dhe organizimit	49,000	49,000	Mbyllur	Telekomunikacione
60	1993	Programi i Zhvillimit Institucional – implementimi i organizatës dhe menaxhimit	383,726	383,726	Mbyllur	Telekomunikacione
61	1993	Programi i Zhvillimit Institucionale – operimi dhe mirëmbajtja fillestare – Përbërësi IV (i)	0	0	Mbyllur	Telekomunikacione
62	1993	Dizajno e detajuar e rrjeteve të abonuesëve	50,470	50,470	Mbyllur	Telekomunikacione
63	1998	Programi i Zhvillimit Administrativ dhe Rregullator në Telekomunikacione	64,250	64,250	Mbyllur	Telekomunikacione
64	1993	Programi i Zhvillimit Institucional – Menaxhimi i Projekteve dhe Implementimi	43,809	43,809	Mbyllur	Telekomunikacione
65	1995	Telekomunikacionet Shqiptare – konsulencë mbi parashikimin e njësisë implementuese	31,025	31,025	Mbyllur	Telekomunikacione
66	1995	Privatizimi i Telekomunikacioneve – konsulencë legale	12,819	12,819	Mbyllur	Telekomunikacione
67	1992	Master plan për Telekomunikacionet	197,708	197,708	Mbyllur	Telekomunikacione
68	1992	Pergatitja e specifikimeve të tenderit	154,907	154,907	Mbyllur	Telekomunikacione
69	1995	Telekomunikacionet Shqiptare – zhvillimi i politikave të sektorit	44,972	44,972	Mbyllur	Telekomunikacione
70	1996	Studim fizibiliteti për zhvillimin e telekomunikacioneve në zonat rurale	12,996	12,996	Mbyllur	Telekomunikacione
71	1992	Telekom	65,889	65,889	Mbyllur	Telekomunikacione
72	1998	Programi i Zhvillimit Administrativ dhe Rregullator në Telekomunikacione	25,058	25,058	Mbyllur	Telekomunikacione
73	1995	Shqyrtim i draftit të ligjit mbi telekomunikacionet	9,810	9,810	Mbyllur	Telekomunikacione
74	1998	Programi i Zhvillimit Administrativ dhe Rregullator në Telekome	80,185	80,185	Mbyllur	Telekomunikacione
75	1999	Programi i Zhvillimit Administrativ dhe Rregullator në Telekome	15,911	15,911	Mbyllur	Telekomunikacione
76	1999	Asistencë për procesin e zgjedhjes së operatorit të dytë GSM	29,945	29,945	Mbyllur	Telekomunikacione
77	1994	CEI – projekti i raportimit të informacioneve të transportit (dizanim dhe mbikqyrje)	156,621	156,621	Mbyllur	Transport, Magazininim
Totali i Angazhuar në Euro:			15,720,491	11,984,190		
Nr. i projekteve:			77			

SHTOJCA 6: ASISTENCA MULTI DHE BILATERALE

I. ASISTENCA MULTILATERALE

Donatorët kryesorë multilateralë në Shqipëri të radhitur në rend alfabetik janë:

BE – PHARE / CARDS

Programi PHARE filloi të veprojë në Shqipëri në 1991. Midis periudhave 1991-2000, Shqipëria ka përfituar mbi 500 milionë Euro ndihma nga PHARE dhe rreth 300 milionë Euro nëpërmjet programeve të tjera si ECHO (ndihmë humanitare), FEOGA (agrikulturë) dhe EDHIR (veprime në demokraci dhe të drejtat e njeriut). Mbështetja e BE-së ka mbuluar një numër të madh sektorësh, duke përfshirë ndihmat humanitare, infrastrukturën, agrikulturën, shendetësinë, arsimin, reformën e administratës publike, zbatimin e legjislacionit dhe sistemin gjyqësor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimin ndër-kufitar.

Që nga 2001, programi Asistenca për Rindërtimin e Komunitetit, Zhvillim dhe Stabilitet (**CARDS**) ka qenë instrumenti financiar kryesor i KE-së për bashkëpunimin në vendet Ballkanike. 187.4 milionë Euro janë caktuar nën programin kombëtar të CARDS për Shqipërinë për periudhën 2001-2004.

Prioritetet kryesore për financim nën programin CARDS rrjedhin nga Dokumenti për Strategjinë e Vendit (CSP) për Shqipërinë, e cila u publikua në 2001. Këto prioritete janë: **Drejtësia dhe Punët e Brendëshme** – ku përfshihen forcimi i gjyqësorit, forcimi i rendit publik, përmirësimi i menaxhimit kufitar dhe lufta ndaj krimit të organizuar, mashtrimeve dhe korrupsionit; **Ndërtimi i Kapacitetit Administrativ** – ku përfshihet përmirësimi i kapacitetit të përgjithshëm zbatues të administratës publike shqiptare, veçanërisht në fusha specifike të lidhura me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit; **Zhvillimi Ekonomik dhe Social** – ku përfshihen fusha thelbësore si tregtia, arsimit dhe infrastruktura lokale; **Mjedisi dhe Burimet Natyrore** – duke përfshirë forcimin institucional (me theks të veçantë në çështjet e implementimit dhe zbatimit), përmirësimin e monitorimit të ndotjes dhe një planifikim më të mirë urban dhe rajonal; **Stabilizimi Demokratik** – që trajton veçanërisht përforcimin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Gjithashtu, Shqipëria përfiton nga Programi Rajonal i CARDS. KE jep gjithashtu edhe një sasi të kufizuar fondesh nën vija specifike buxheti në fushat e mjedisit, të drejtave të njeriut, Drejtësisë dhe Punëve të Brendëshme, dhe Kuadrit VI për Kërkime, nga të cilat Shqipëria mund të përfitojë rast pas rasti.

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE (BEI)

Fokusi primar i BEI-t në Ballkanin Perëndimor ka qenë deri tani financimi i rindërtimit të infrastrukturës bazë – konsideruar si një element thelbësor në zhvillimet e fillestare të rajonit. BEI e ka plotësuar këtë fokus me projekte të arkitektuara për nxitjen e sektorit privat dhe SME-ve në veçanti.

Që nga 1994, EIB ka angazhuar 164 milionë Euro në Shqipëri. Në vitet e fundit BEI angazhoi 34 milionë Euro për rehabilitimin e korridorit Veri-Jug, 30 milionë Euro për Transmetimin dhe Shpërndarjen e Energjisë Elektrike (projekt i bashkë-financuar nga BERZH, BB dhe donatorë të tjerë bilateralë), 17 milionë Euro për rehabilitimin e Portit të Durrësit dhe 15 milionë Euro për rehabilitimin e furnizimit me ujë të pijshëm në pesë qytete të Shqipërisë nën skemën konçesionale nga KE dhe donatorë të tjerë.

Strategjia afat-mesme e BEI-t për Ballkanin Perëndimor identifikon si fusha prioritare të investimit transportin, energjitikën dhe komunikacionet. Në përputhje me këto prioritetë, BEI po bashkëpunon me BERZH-in për bashkë-financimin e një segmenti të Korridorit Veri-Jug dhe ndërtimin e një terminali tragetesh në Portin e Durrësit. Gjithashtu, në bashkëpunim me BERZH-in dhe BB-në, BEI po punon në financimin e një termocentrali në Vlorë.

FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Shqipëria hyri në FMN në Tetor 1991. Që atëhere ajo ka përfituar nga katër programe të FMN-së që mbështesin reformat e qeverisë në ekonomi. Një program tre vjeçar i FMN-së (ESAF), i cili u aprovua nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së në Maj 1998, u mbyll në Korrik 2001. Me anë të huave prej rreth 60 milionë Dollarë amerikanë, ai ndihmoi politikën fiskale dhe monetare të Shqipërisë si dhe reforma të rëndësishme institucionale, si privatizimi i ndërmarrjeve strategjike dhe SME-ve dhe reforma në administratën publike për të ulur korrupsionin dhe rritur transparencën.

Në 21 Qershor 2002, FMN aprovoi një program ekonomik tre-vjeçar të mbështetur nga një Program për Rritjen Ekonomike dhe Uljen e Varfërisë (PRGF) për një shumë ekuivalente me 41.5 milionë Dollarë amerikanë. Deri tani, Shqipëria ka tërhequr rreth 17.8 milionë Dollarë amerikanë nën marrëveshjen aktuale të PRGF-së nga FMN. PRGF është mjeti me terma më të zbutura i FMN-së për vende më të ardhura të ulta. Programet e mbështetura nga PRGF bazohen në strategji vendore të reduktimit të varfërisë të adoptuara mes një procesi që përfshin pjesëmarrjen shoqërisë civile dhe partnerëve të zhvillimit. Programet shtjellohen në Planin Strategjik të Reduktimit të Varfërisë (PRSP). Në 23 janar 2004, Bordi Ekzekutiv i FMN përfundoi shqyrtimin e tretë të ecurisë ekonomike të Shqipërisë nën marrëveshjen e PRGF-së, i cili rezultoi në lëvrimin e një shume prej rreth 5.9 milionë Dollarë amerikanë për Shqipërinë.

GRUPI I BANKËS BOTËRORE / IDA

Shqipëria hyri në Bankën Botërore dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) në Tetor 1991. Objektivat kryesore të Bankës Botërore kanë qenë reduktimi i varfërisë dhe nxitja e rritjes dhe zhvillimit të sektorit privat në vend. IDA i përqëndroi burimet e saj në fusha kritike për rritjen ekonomike dhe për reduktimin e varfërisë. Deri tani IDA ka aprovuar 52 projekte në Shqipëri për një total prej 719 milionë Dollarë amerikanë, nga të cilët 23 janë në zbatim. Shuma totale e lëvruar arrin 495 milionë Dollarë amerikanë.

Në vitin fiskal 2002, IDA financoi disa projekte: Projekti i Zhvillimit të Peshkimit (5,6 milionë Dollarë amerikanë); Rehabilitimi dhe Rindërtimi i Sektorit të

Energjistikës (29.9 milionë Dollarë amerikanë) si pjesë e një projekti të gjerë të financuar nga BERZH, BEI, Qeveria Italiane dhe vende të tjera donatore; Kredia për Rregullimin e Sektorit Financiar (15 milionë Dollarë amerikanë). Në vitin fiskal 2003 IDA aprovoi 18 milionë Dollarë amerikanë financim nën Kreditë e Dytë Mbështetëse për Reduktimin e Varfërisë së bashku me projekte të tjera: Uji i Pijshëm dhe Ujërat e Zeza në Bashki (15 milionë Dollarë amerikanë); Shtesë për Mirëmbajtjen e Rrugëve (13 milionë Dollarë amerikanë); Punë në Komunitet II (15 milionë Dollarë amerikanë).

Strategjia e Asistencës për Vendin (CAS) e IDA-s për vitet fiskale 2003-05 u aprovua në Qershor 2002. Ajo përbën kuadrin mbështetës për Strategjinë Kombëtare të Shqipërisë për Zhvillim Social-Ekonomik (NSSD) nën mendimin se Shqipëria ka mundësi të lëvizë nga menaxhimi afat-shkurtër i krizës në një vizion afat-gjatë për zhvillim të qendrueshëm. Prioritetet e saj strategjike janë (i) përmirësimi i qeverisjes dhe forcimi i institucioneve, (ii) promovimi i rritjes së qendrueshme të sektorit privat, dhe (iii) nxitja e zhvillimit të njerëzve nëpërmjet arsimimit më të mirë, shëndetësisë dhe enteve të tjera sociale.

GRUPI I BANKËS BOTËRORE /IFC

Shqipëria u bë anëtare e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) në 1991. IFC po rrit praninë e saj në Shqipëri:

- duke rritur mbështetjen për sektorin financiar, përfshirë privatizimin, investimin dhe ristrukturimin e sektorit të tregut financiar;
- duke kërkuar mundësi për financimin e investimeve në sektorin privat në infrastrukturë dhe duke kryer financuar investimeve të zgjedhura fusha kritike të infrastrukturës;
- duke siguruar asistencë financiare dhe teknike për SME-të në fazën e post-privatizimit.
- duke rehabilituar sektorët kyç industrialë si nafta dhe gazi, minierat dhe industrinë e lidhura me to, dhe materialet e ndërtimit.
- duke mbështetur zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ku Shqipëria ka avantazh si manifakturat e lehta, peshkimi dhe turizmi.

Portofoli i IFC-së në vend arrin deri tani në 130.5 milionë Dollarë amerikanë. IFC dhe BERZH kanë bashkë-financuar projekte në sektorin financiar (Banka ProCredit, Banka Kombëtare Tregtare, INSIG) dhe në sektorin e korporatave private në Shqipëri (Vodafone Albania). Banka dhe IFC janë duke bashkëpunuar aktualisht në financimin e rehabilitimit dhe zgjerimit të Fabrikës së Çimentos në Fushë-Krujë.

II. ASISTENCA BILATERALE

Donatorët më të mëdhenj bilaterale në Shqipëri (më shumë se 50 milionë Euro të lëvruara gjithsej) në rend alfabetik janë:

GJERMANIA

Qeveria Gjermane, si një nga partnerët më të rëndësishëm në Shqipëri në bashkëpunimin për zhvillim, ka angazhuar deri me sot një shumë totale prej 320 milionë Euro, nga të cilat 248 milionë Euro në bashkëpunim financiar dhe 72 milionë Euro në asistencë teknike.

Projektet e bashkëpunimit financiar janë implementuar nga KfW si përfaqësuese e Qeverisë Federale Gjermane dhe përqëndrohen në sektorët e mëposhtëm:

- *Ujërat e zeza dhe furnizimi me ujë të pijshëm* – 114 milionë Euro janë angazhuar deri tani në qytete të ndryshme duke përfshirë si investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit ujor ashtu edhe implementimin e masave mbështetëse institucionale në nivele bashkiake.
- *Sektori financiar* – projekti kryesor është Banka ProCredit, institucioni kryesor mikro-financiar në Shqipëri, ku janë gjithashtu aksionerë edhe BERZH-i dhe IFC-ja.
- *Sektori i energjitikës* – volumi i financimeve për sektorin arrin në 31 milionë Euro. Fondet janë përqëndruar kryesisht në prodhimin rajonal hidro-energjitik dhe programin e shpërndarjes në jugun e Shqipërisë. Në koordinim të afërt me IFI dhe donatorë të tjerë po adresohet gjithashtu edhe përmirësimi institucional dhe financiar i sektorit.
- *Infrastruktura* – një nga ndërhyrjet më të rëndësishme në sektor ka qenë rikonstruksioni i pistës së Aeroportit të Tiranës, një projekt prej 25 milionë Euro.
- *Infrastruktura në Shkallë të Vogël dhe Banesat:* – janë siguruar angazhime prej 15 milionë Euro të cilat përqëndrohen në projekte me kërkesa të lartë pune njerëzore.

Programet e asistencës teknike implementohen nga agjensia qeveritare GTZ dhe përqëndrohen kryesisht në trajnimin arsimor/profesional, nxitjen e zhvillimit rural dhe forcimin e sistemit ligjor.

Bashkëpunimi në 2004-5 do të vazhdojë të përqëndrohet në sektorët e furnizimit me ujë dhe energji. Fusha të tjera prioritare do të jënë zhvillimi i infrastrukturës sociale në shkallë të vogël dhe mbrojtja e mjedisit.

GREQIA

Përveç faktit së është partneri i dytë më i madh tregtar i Shqipërisë dhe një nga gjeneruesit më të fuqishëm të FDI-ve, Greqia, ka siguruar gjithashtu asistencë në formë grantesh dhe fondesh për bashkëpunim teknik duke u përqëndruar kryesisht në bujqësi, infrastrukturë banimi në zonat rurale dhe urbane, dhe shërbime sociale (shëndetësi, arsim).

Greqia ka nënshkruar një program pesë-vjeçar bashkëpunimi për zhvillim (2002-2006) me Shqipërinë nën Planin Helenik për Rindërtimin Ekonomik të Ballkanit për një shumë totale prej 50 milionë Euro. Programi i zhvillimit fokusohet në: (i) modernizimin e infrastrukturës, veçanërisht energjitikës dhe transportit; (ii) nxitjen e investimeve prodhuese; (iii) modernizimin e vetë-qeverisjes dhe administratës publike; (iv) mbështetjen e institucioneve demokratike; (v) mbështetjen e zbatimit të

ligjit dhe të shtetit social; (vi) trajtimin e pabarazive ekonomike; dhe (vii) mbështetjen për trajnim arsimor dhe profesional, për administratën dhe potencialin shkencor.

ITALIA

Italia është pa dyshim donatori bilateral më i madh për Shqipërinë me fonde totale të lëvruara për periudhën 1991-2002 prej 353 milionë Dollarë amerikanë. Asistenca e Italisë për Shqipërinë ka evoluar nga ndihma e emergjencës në fazat e para të tranzicionit dhe kohëve të krizës, në një strategji zhvillimi afatgjatë. Programi i asistencës për 2002-2004 për Shqipërinë parashikon mbështetje të mëtejshme për një total prej 202 milionë Euro. Programi i asistencës për 2002-2004 përqendrohet tek:

- *Sektori i energjisë elektrike* – kjo ka qenë fusha kryesore e mbështetjes që nga viti 1994 kur u siguruan fonde të shumta për ndërhyrje emergjente si edhe për rehabilitimin e përbërësve të ndryshëm të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Italia është një nga pjesëtarët aktivë në mbështetjen aktuale ndërkombëtare për sektorin energjitik në Shqipëri bashkë me BERZH-in, Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë.
- *Furnizimi ujqor* – financimi për këtë sektor ka qenë i përqendruar kryesisht në zonën rreth Tiranës dhe përfshin asistencë për një program strukturor për mbështetjen e kompanisë lokale të furnizimit.
- *Infrastruktura e rrugëve* – Italia ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në këtë sektor përmes financimit për rehabilitimin e segmenteve të ndryshme urbane dhe kombëtare, asistencë teknike për përmirësime strukturore në Drejtorinë e Rrugëve dhe mbështetje për riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Ajo gjithashtu bashkë-financon projektin e rehabilitimit të rrugës Elbasan-Librazhd me BERZH-in.
- *Projekte të tjera të sektorit të transporteve* në të cilat është përqendruar Italia përfshijnë edhe hekurudhat dhe portet. Italia po konsideron të kontribuojë në përpjekjet e përbashkëta të BE-së, BEI-t, BERZH-it dhe donatorëve të tjerë për të mbështetur ristrukturimin dhe rehabilitimin e porteve të Durrësit dhe Vlorës.
- *Shërbimet sociale*, kryesisht sistemet e shëndetësisë dhe arsimit, kanë përfituar gjithashtu nga mbështetja italiane. Rindërtimi i shkollave, programet e shkëmbimit mes universiteteve dhe rehabilitimi i qendrave të kujdesit shëndetësor kanë qenë disa nga fushat kryesore të asistencës.

JAPONIA

Japonia është një donator tjetër i rëndësishëm i Shqipërisë. Asistenca bilaterale e Japonisë filloi në 1990 dhe përfshin një numër programeshvrimi total arriti në 52.4 milionë Dollarë amerikanë në fund të 2000. Kjo mbështetje përbëhet nga 11.4 milionë Dollarë amerikanë (22%) grante, 11.1 milionë (21%) asistencë teknike dhe 29.9 milionë Dollarë amerikanë (57%) kredi. Japonia u rendit e katërta midis donatorëve bilateralë në 1997.

Projektet më të mëdha të lançuara kanë qenë një kredi prej 2.2 miliardë Jen (rreth 20 milionë Dollarë amerikanë) në 1994 për sektorin e bujqësisë, një kredi prej 1.7 miliardë Jen në 1995 për rehabilitimin e stacionit hidroenergjitik të lumit Drin dhe një

kredi prej 3.1 miliardë Jen në 1996 për një projekt për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike. Projekti i fundit u bashkë-financua me BERZH-in.

Asistenca teknike grantet kanë përfshirë:

- Asistencë emergjence – ndihmë gjatë trazirave të Marsit 1997;
- Dhurime të pajisjeve dhe ndërtesave mjekësore si dhe asistencë në fushën e prodhimit të ushqimit dhe bilancit të pagesave në 1999-2000 në përgjigje të krizës së Kosovës.

ZVICRA

Në kuadrin e bashkëpunimit bilateral midis Shqipërisë dhe Zvicrës janë aprovuar disa projekte që nga 1991 në fushën e energjitikës (përkrah BERZH-it dhe IFI-ve të tjera), bujqësisë, transportit, telekomunikacioneve, privatizimeve dhe zhvillimit të sektorit privat nëpërmjet nxitjes së institucioneve të mikro-kreditit për komunitetet lokale.

SHBA / USAID

Programi i USAID-it në Shqipëri mbështet rritjen ekonomike dhe modernizimin e sektorit bujqësor, si dhe zhvillimin demokratik dhe stabilitetin social. Objektivat e programit të USAID-it janë përcaktuar në Planin Strategjik për Punët Ndërkombëtare të SHBA-së: nxitja e rritjes ekonomike në bazë të gjerë, forcimi i pranimi dhe zbatimit nga qeveritë e huaja të praktikave demokratike dhe respektimit të të drejtave të njeriut, mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe të siguria se mungesa e stabilitetit në shkallë rajonale nuk do të kercënojnë sigurinë dhe mirëqënien e SHBA-së dhe aleatëve të saj.

Asistenca e USAID-it për vitet 2003-2004 përqendrohet në: (i) nxitjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimin e sektorit bujqësor me anë të rritjes së investimit privat, rritjes së mundësive të kreditimit dhe forcimit të sistemit bankar; (ii) reformat demokratike për mbështetjen e shoqërisë civile, asistencën për zgjedhjet, forcimin e institucioneve ligjore, mbështetjen e programit të qeverisë për decentralizimin; dhe (iii) reformat në shëndetësi për përmirësimin e kujdesit shëndetësor me anë të zhvillimit dhe implementimit të modeleve cilësore të kujdesit, forcimit të kapaciteteve drejtuese në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së komunitetit për të siguruar shërbim më të mirë shëndetësor.

USAID-i është donatori i katërt më i madh në përgjithësi dhe i donatori i dytë bilateral në Shqipëri me një angazhim total prej 368 milionë Dollarë amerikanë deri në fund të 2003, nga të cilat 21 milionë Dollarë amerikanë u dhanë në 2003. USAID planifikon të vejë në lëvizje rreth 24 milionë Dollarë amerikanë shtesë në 2004 në projekte që mbulojnë prioritetet e tij strategjike.

Donatorë të tjerë kanë gjithashtu plane për të rritur në mënyrë të ndjeshme mbështetjen e tyre për Shqipërinë në të ardhmen. Në veçanti, **Hollanda** ka vendosur të rrisë volumnin e asistencës bilaterale. Asistenca për mbrojtjen e mjedisit është një nga prioritetet e saj kryesore. Mbështetja mjedisore do të përfshijë projekte institucionale në nivele rajonale, qendrore dhe bashkiake dhe do të përfshijë gjithashtu bashkëfinancim të projekteve mjedisore të Bankës Botërore për për të pastruar zonat e

ndotura. Në vitin 2003 u angazhuan rreth 1 milion Euro . Një shumë totale prej rreth 9 milionë Euro do të vihet në dispozicion për periudhën 2003-2006. 10 milionë Euro të tjera do të shpenzohen gjatë të njëjtës periudhë për të promovuar qeverisje të mirë në fushën publike.